



Axhendë shqiptare për sigurinë rajonale

An albanian agenda for regional security

Fjalimet e mbajtura në konferencën

Axhendë shqiptare
për sigurinë rajonale
Albanian agenda for regional security

Hotel Tirana International
7-8 mars 2006

Konferencë realizuar nga
Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim,
me mbështetjen e
Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s

Përmbledhja dhe redaktimi i fjalimeve nga Enis Sulstarova
Përkujdesja pamore Kaligrafik.net
Shtypi Gent Grafik

Përmbajtja

Mbi një axhendë shqiptare të sigurisë rajonale	7
“NATO: Sfidat dhe e ardhmja”	9
<i>Sotiraq Hroni - Drejtor ekzekutiv i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim</i>	
“Shqiptarët i mbeten përjetë mirënjohës NATO-s”	11
<i>Prof. Dr. Sali Berisha – Kryeministër i Shqipërisë</i>	
“Ne mbështesim aspiratat euro-atlantike të Shqipërisë dhe fqinjëve të saj”	14
<i>Marcie Ries – Ambasadore e SHBA</i>	
“Bashkëpunimi rajonal në kuadër të integritimit në NATO”	17
<i>Darko Javorski – Ambasador i Kroacisë</i>	
“Karta e Adriatikut dhe NATO”	21
<i>Besnik Musafaj – Ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë</i>	
“Sfidat politike të sigurisë”	24
<i>Leonard Demi – Kryetar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare</i>	
“Një studim mbi marrëdhëniet ndërkufitare në nivel vendor”	29
<i>Prof. Ass. Dr. Dhimitër Doka – Universiteti i Tiranës</i>	
“Marrëdhëniet ndërkufitare në zonën e Shkodrës”	33
<i>Gjovalin Kolombi – Prefekt i Qarkut të Shkodrës</i>	
“Bashkëpunimi i policisë kufitare në Dibër me kolegët e tyre maqedonas”	37
<i>Xhaferr Seiti – Prefekt i Qarkut të Dibrës</i>	
“Reformat e Sigurisë Kufitare”	41
<i>Drejtuues Bajram Ibraj – Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit</i>	
“Hapat drejt sigurisë kufitare të Shqipërisë, sipas standarteve europiane”	48
<i>Joachim Tasso Villalonga – Delegacioni i Komisionit të Bashkimit Evropian</i>	
“Reformimi i Policisë së Shtetit dhe siguria ndërkufitare”	51
<i>Klaus Schmidt – PAMECA</i>	
“SEDM: Një nismë e suksesshme rajonale për sigurinë kolektive”	55
<i>Besnik Baraj – Kryetar i Sekretariatit Ministerial të Mbrojtjes i Evropës Juglindore</i>	
“Ndihmesa e OSBE në çështjet e sigurisë”	58
<i>Jack Bell – Departamenti i Bashkëpunimit të Sigurisë, OSBE</i>	
“Marrëdhëniet rajonale dhe diplomacia shqiptare”	60
<i>Agim Fagu – Drejtor i Drejtorisë së NATO-s, Ministria e Punëve të Jashtme</i>	
REKOMANDIMET E KONFERENCES	63
SUMMARY OF THE SPEECHES	66
RECOMMENDATIONS OF THE CONFERENCE	90

MBI NJË AXHENDË SHQIPTARE TË SIGURISË RAJONALE

Shqipëria po përparon në mënyrë të vendosur prej anëtarësimit në NATO. Qysh në fillim të viteve 1990, qeveritë shqiptare kanë përqafuar parimet për sigurinë kolektive të NATO-s dhe kanë ndërmarrë reforma institucionale të nevojshme për t'u bërë pjesë e aleancës. Shqipëria ka qenë protagoniste në nismat e Partneritetit për Paqe dhe Kartën e Adriatikut.

Së bashku me anëtarët e NATO-s dhe me partnerët e Partneritetit për Paqe prej vendeve të Evropës Juglindore, Shqipëria është zotuar të japë ndihmesën e saj që në mënyrë kolektive të përballen sfidat e sigurisë në shekullin e ri. Koncepti i sigurisë ka ndryshuar, nga të qenit kombëtar dhe ushtarak në një koncept më të gjerë të sigurisë kolektive për t'u ndeshur sa më mirë me sfida të tilla si fatkeqësitë natyrore, krimin e organizuar, terrorizmin ndërkombëtar, kontrollin e kufijve, etj. Në këtë koncept të zgjeruar të sigurisë luanë rol të madh sektori civil i shoqërisë, si edhe partneriteti midis shteteve. Për ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në Evropën Juglindore situatat në zonat kufitare janë të një rëndësie të veçantë, sepse destabiliteti i tyre kërcënon sigurinë e shteteve të tërë rajonit, Prandaj vendet e rajonit dhe NATO kanë miratuar South East Europe Common Assessment Paper on Regional Security Challenges and Opportunities, një dokument ky që orienton përpjekjet e përbashkëta të rajonit për sigurinë kolektive dhe në kuadër të integriteteve euro-atlantike.

Anëtarësimi në NATO kërkon përshtatje të vazhdueshme institucionale dhe një vullnet për të marrë përsipër përgjegjësi në përballjen e sfidave të tanishme ndaj sigurisë. Për të trajtuar perspektivën shqiptare ndaj sigurisë rajonale, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, mbështetur nga Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s, organizoi në Tiranë më 7-8 mars 2006 konferencën "Axihendë shqiptare për sigurinë rajonale", me pjesëmarrjen e personaliteteve politike të pushtetit qendror dhe vendor, parlamentarë, ambasadorë të vendeve aleate të Shqipërisë, specialistëve kombëtarë dhe

ndërkombëtarë të çështjeve të sigurisë, shoqërisë civile dhe mediaeve. Konferenca u zhvillua në kuadër të një aktiviteti më të gjerë, "NATO": Sfidat dhe e Ardhmja", i cili përfshinte edhe simpoziumin me studentë dhe aktivistë të rinjë "NATO: E shkuara, e tashmja dhe e ardhmja", të organizuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë në partneritet me organizata të shoqërisë civile shqiptare.

Në këtë botim janë përfshirë fjalime që u mbajtën në konferencën "Axhendë shqiptare për sigurinë rajonale" dhe rekomandimet që dolën prej saj, në mënyrë që të vlejnjë për bashkërendimin e politikave shqiptare, në nivel qendror dhe vendor, në drejtim të sigurisë rajonale. Shpresojmë që diskutimet e konferencës dhe rekomandimet të japin ndihmesën për hartimin e një axhende kombëtare shqiptare të sigurisë në rajonin tonë, e cila do të orientojë bashkëpunimet e Shqipërisë me partnerët rajonalë dhe me gjerë, si edhe do të jetë në funksion të integritimeve euro-atlantike të vendit dhe rajonit.

“NATO: Sfidat dhe e ardhmja”

Sotiraq Hroni

Drejtor ekzekutiv i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

*I nderuar Kryeministër Berisha,
Shkëlqesi Ambasadorë,
Të nderuar deputetë, dhe drejtues të institucioneve qendore dhe vendore,
Të dashur studentë dhe të ftuar në Konferencë*

Me kënaqësi jo të zakonshme, kam rastin të hap konferencën e sotshme, një ngjarje kjo e veçantë, për vetë faktin se ky aktivitet shfaqet si një ndërthurje për të sjellë dhe ndarë përgjegjësitë e vendit në nivel kombëtar dhe vendor së bashku me përfaqësues studentorë nga Shqipëria dhe mbarë rajoni. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, mbështetur nga Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s, e vlerëson këtë aktivitet si një mundësi për të diskutuar dhe vlerësuar nevojën e një kohezioni të brendshëm dhe funksional të institucioneve në nivel qendror dhe vendor për një zhvillim sa më të plotë dhe ndarje të përgjegjësive në kuadër të sfidave të sigurisë dhe të zhvillimit të integruar të vendit në mënyrë të veçantë në zonat e kufijve tokësorë të tij.

Ndërgjegjësimi i të gjithë shoqërisë për objektivat dhe detyrat për një vend të merituar në NATO kërkon të shikojmë më shumë së brendshmi, për të arritur një kohezion të plotë kombëtar në të gjitha planet, sikundër dhe në vlerësimin gjithfaktorial të rolit që vazhdon të japë me sukses Shqipëria në sigurinë rajonale. Zhvillimi ekonomik i harmonizuar i çdo pjese territoriale të vendit, zhvillimi i infrastrukturës, vendosja e partneriteteve bashkëpunuese me interes të ndërsjellë të institucioneve publike dhe jo publike në një plan ndërkufitar mbetet një sfidë për shoqërinë shqiptare. Ajo vjen si një domosdoshmëri për vetë faktin se integrimi rajonal dhe bashkëpunimi ndërkufitar mbeten në themel të arritjeve për një integrim sa më të shpejtë në strukturat Euro-Atlantike.

Nje axhendë shqiptare për sigurinë rajonale është para së gjithash një vizion udhërrëfyes për një Europë demokratike dhe pa vija ndarëse, ku zgjerimi i NATO-s është një hap përcaktues drejt këtij vizioni. Sfidën shqiptare për integrim në NATO kjo konferencë synon ta prekë duke bërë vlerësime e përcaktuar rekomandime për çështje të tilla si ajo e shkallës së bashkëpunimit dhe bashkërendimit nga pushtetet qendrore dhe vendore me strukturat partnere të vendeve fqinj për nxitjen dhe zhvillimin e zonave kufitare, kontrollin dhe nxitjen

e tregtisë, parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe degradimit mjedisor e të tjera.

Sfidat shqiptare të sigurisë janë njëkohësisht edhe sfidat rajonale të sigurisë, asnjë shtet i vetëm nuk mund t'i përballojë këto sfida, prandaj bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar si dhe procesi i vazhdueshëm integrues janë të pashmangshëm në përafrimin e një të ardhme më të sigurtë dhe të begatë të qytetarëve të këtij rajoni mbështetur në vlerat perëndimore. Dhe për këtë pritet që theks i veçantë të vendoset tek inisiativa shqiptare për rregullimin ligjor dhe thellimin e bashkëpunimeve dhe shkëmbimeve të gjithanshme ndërkufitare. Po aq e rëndësishme mendoj se mbetet ngritja dhe forcimi i kapaciteteve menaxheriale në administratat vendore për të hyrë në projektet e nevojshme dhe nxitur bashkëpunime ndërkufitare.

Kjo konferencë në ambicien e saj kërkon të vendosë axhendën shqiptare brenda një kuadri dhe axhende rajonale të sigurisë, e cila do të lehtësonte procesin integrues euro-atlantik duke harmonizuar interesat rajonale në dobi jo vetëm të stabilitetit por edhe të së ardhmes së vlerave të përbashkëta euro-atlantike.

Sfidat e integritit janë gjithsesi çështje të sigurisë njerëzore dhe të parametrave perëndimorë të realizimit të të drejtave të njeriut. Prandaj, ky aktivitet ndryshe nga çdo tjetër realizuar deri tani, përbën një hapësirë të rëndësishme dhe një pritshmëri të lartë dhe kërkon t'i japë një kriteri bazë të integritit, plotësisht sa më të plotë të nevojave njerëzore dhe të respektimit të të drejtave universale të njeriut. IDN është e mendimit se problemet dhe vështirësitë ekonomike dhe sociale në mënyrë të veçantë në zonat rurale e ndërkufitare ende nuk po vlerësohen gjerësisht si probleme me një impakt negativ dhe kërcënues për sigurinë dhe stabilitetin edhe rajonal.

Si organizator, ndjehem i nderuar për pjesëmarrjen e Kryeministrit të vendit në çeljen e këtij aktiviteti dy ditor, që nga njëra anë do të synojë edukimin e liderve të rinj me vlerat dhe sfidat e Aleancës, ndërsa nga ana tjetër, kërkon të riformatojë bashkëpunimin dhe të transmetojë përgjegjësitë në të gjithë aktorët vendorë publike dhe jo-publikë në zonat kufitare për përballimin e sfidave të vendit dhe të sigurisë rajonale. Prania dhe vlerësimi që Kryeministri Berisha i bën këtij aktiviteti jep shpresën që rekomandimet e konferencës do të orientojnë mjaftueshëm punën e institucioneve si në nivel qendror, ashtu edhe në atë vendor. Më lejoni me këtë rast, të nderuar pjesëmarrës, t'i jap fjalën e rastit Prof. Dr. Sali Berishës.

SHQIPTARET I MBETEN PERJETE MIRENJOHES NATO-S

*Prof. Dr. Sali Berisha
Kryeministër i Shqipërisë*

Jam shumë i lumtur të marr pjesë në këtë simpozium të organizuar me liderët e rinj, me studentët, si atlantistë të flaktë, me përfaqësues të komunitetit diplomatik, të legjislativit shqiptar, të forcave të armatosura. Me këtë rast unë dëshiroj të falenderoj organizatorët për organizimin e kësaj konference dhe të theksoj se e konsideroj shumë të rëndësishëm dialogun me të rinjtë, për problemet e Aleancës së Atlantikut të Veriut, probleme të anëtarësisë së Shqipërisë në këtë aleancë, të pozicionit të saj, procese që kanë të bëjnë me themelin e sigurisë, garantimin e lirisë, demokracisë dhe vlerave të tyre në Shqipëri. Mendoj se duke debatuar me të rinjtë problemet madhore shqetësuese, projektimin e vendit në të ardhmen e saj, ne i bëjmë ata bashkautorë në këto politika, të cilat do të jenë përcaktuese për të ardhmen e vendit.

Le të kthehemi tek tema e ditës. Pse është NATO-ja e rëndësishme për Shqipërinë, pse shqiptarët e përkrahin kaq fuqishëm Aleancën e Atlantikut të Veriut? Së pari, mendoj se antarësimi i Shqipërisë në NATO është mënyra më e mirë dhe këtë e perceptojnë në tërësi shqiptarët për garantimin e paqes, stabilitetit dhe sigurisë në vendin e tyre. Së dyti, duke patur parasysh faktin se NATO është para së gjithash një organizatë politike e vendeve të lira, hyrja në NATO është jetike për konsolidimin e demokracisë, lirisë individuale, shtetit ligjor dhe zhvillimit ekonomik. Së treti, pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë klub kaq të respektuar, në Aleancën më të suksesshme politike dhe ushtarake që kohërat kanë njohur ndonjëherë e bën vendin tonë të vogël të fitojë një prestigj dhe të drejtë që nëpërmjet këtij forumi të trasmetojë fuqishëm zërin dhe vizionin e saj për një botë më të sigurtë. Së fundi, shqiptarët si komb i mbeten përjetë mirënjohës NATO-s. Ishte kjo Aleancë e cila ndërromori me një dimension të ri të saj, atë të mbrojtjes të lirisë dhe të drejtave njerëzore, operacionin më të madh ushtarak në Europën e pasluftës dhe liroi shqiptarët e Kosovës nga një regjim shtypës, një regjim apartheidi.

Me rënien e perdes së hekurt vendin e kërcënimit nga ekspansioni sovjetik e zunë kërcënime të reja për sigurinë globale, siç janë konfliktet ndëretnike, terrorizmi ndërkombëtar, rreziku që arsenalet bërthamore të krijuara gjatë luftës së ftohtë të bien në dorën e regjimeve zuzare, të papërgjegjshme. Në konceptin e ri të sigurisë kësaj liste i shtohet krimi i fuqishëm i organizuar, dobësimi i

strukturave shtetërore dhe korrupsioni i lartë, rreziku nga arsenalet e vjetra të armëve konvencionale dhe kimike dhe biologjike të kohës së Luftës së Ftohtë. Ngjarjet e 11 shtatorit 2001 demonstruan qartë se asnjë vend, as dhe superfuqia e vetme e botës, Shtetet e Bashkuara, nuk është i imunizuar nga rreziku i këtyre kërcënimeve. Nga ana tjetër ne jetojmë në një botë globale, që përveç mundësive të mëdha ekonomiko-financiare dhe teknologjike që ofron globalizmi, ai ka krijuar edhe një situatë të vërtetë ndërvarësie, ku askush nuk mund të thotë se ajo që ndodh në një skaj apo në një pjesë tjetër të kontinentit apo planetit, nuk ndikon në vendin apo rajonin e tij. E kundërta është e vërtetë. Në këto kushte, siguria e çdo vendi është e pandashme dhe drejtpërsëdrejti e varur nga siguria kolektive e të gjithëve, çka përbën dhe vetë moton e Aleancën. Neni 5 i Traktatit të Atlantikut të Veriut parashtron qartë parimin e solidaritetit, duke u shprehur se një sulm i armatosur kundër një apo më shumë prej antarëve të NATO-s do të konsiderohet si një sulm kundër të gjithëve. Në një botë globale edhe kërcënimet marrin dimensione ndërkombëtare dhe vetëm nëpërmjet një bashkëpunimi mbi bazën e parimit të solidaritetit të sipërpërmendur ato mund të përballohen në mënyrën më të mirë e të sigurtë. Konfliktet e rrezikshme ndëretnike në rajonin e ish-Jugosllavisë si dhe paaftësia ëpr t'i zgjidhur ato nga vetë vendet e rajonit diktuan nevojën e bashkëpunimit të ngushtë, ndërhyrjen e drejtpërdrejtë ndërkombëtar për ndërprerjen e luftrave, duke patur këtu rolin vendimtar të NATO-s për paqen dhe stabilitetin në rajon. Mësimet që u nxorën nga Bosnja bënë të mundur që Aleanca dhe komuniteti ndërkombëtar të dominojë brenda disa muajve konfliktin në Kosovë, të parandalojë brenda disa javëve shtrirjen e tij në Maqedoni. Përsosja e mëtejshme e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar është një nga domosdoshmëritë më të mëdha që rreziqet e reja të përballohen me sukses. Prania e NATO-s në rajonin e Ballkanit me KFOR-in është një faktor madhor paqeje dhe stabiliteti në rajonin tonë. Karta e Adriatikut 3 është një tjetër shembull i shkëlqyer i kontributit, që nismat rajonale, në kuadër të partneritetit për paqe japin në shërbim të stabilitetit dhe sigurisë së rajonit.

Le t'i kthehemi NATO-s përse i përket zhvillimeve brenda vetë vendeve antare. Në preambulën e Traktatit të Atlantikut të Veriut janë të konfirmuara parimet themelore të organizatës. Shtron si kusht themelor që vendet anëtare të NATO-s duhet medoemos të jenë të vendosura të ruajnë lirinë, trashëgiminë e përbashkët dhe qytetërimin e popujve të tyre, të ngritura mbi parimet e demokracisë, liritë individuale dhe të sundimit të ligjit. Gjatë këtyre pothuajse 57 viteve të saj, NATO-ja e ruajti me përgjegjësi të madhe identitetin e saj si klub ekskluziv i vendeve të lira e demokratike. Është kjo arsyeja që qysh në vitin 1992 Shqipëria, e sapo dalë nga regjimi më totalitar i Europës, kërkoi të anëtarësohej në NATO, duke u bërë kështu i pari vend i ish kampit komunist të ndrërmarrë një hap të tillë. Duke besuar në mënyrë të palëkundur në parimin se siguria fitohet me përgjegjësi, ne e pamë opsionin e antarësimit në NATO si një yll polar që do të udhëhiqte Shqipërinë në përpjekjet saj për demokratizimin e vendit, kon-

solidimin e shtetit ligjor dhe krijimin e shoqërisë, ku respektohen plotësisht liritë e të drejtat e individit. Strategjia e integritit të Shqipërisë në NATO bazohet në planin e aksionit për antarësim. Ky plan parashikon një sërë reformash, qëllimi i të cilave është zhvillimi dhe forcimi i vendit, duke promovuar një ekonomi eficiente të tregut të lirë, forcimin e institucioneve, thellimin e demokracisë, vendosjen e shtetit ligjor, shtypjen e kriminalitetit dhe luftën kundër korrupsionit, forcimin e kontrollit të kufijve, sigurisë së porteve, të vijës bregdetare, reformimin e forcave të armatosura duke i kthyer ato në ushtri moderne, profesioniste, të standarteve bashkohore, e aftë për t'iu përgjigjur sfidave të këtij shekulli. Megjithëse jemi të vetëdijshëm se mbetet shumë punë për të bërë, sidomos në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, luftën kundër fenomenit të state capture, plani për antarësim ka qenë dhe mbetet harta e rrugës dhe së bashku me procesin e Stabilizim Asociimit përbëjnë projektet më madhore të shoqërisë dhe shtetit shqiptar. Sot Shqipëria gëzon më shumë stabilitet, më shumë demokraci dhe një vizion shumë më të qartë për të ardhmen e saj.

Le të vimë tek realiteti i ri i krijuar pas rënies së komunizmit, por në veçanti pas ngjarjeve të 11 shtatorit. Ndryshimet e situatës globale detyrimisht që do të sjellin ndryshime dhe në filozofinë dhe strategjinë e NATO-s dhe do bënin që kjo aleancë të ndërmerete të gjitha reformat për t'iu përballur me sukses me situatën e re, për të marrë përsipër rolin e saj të ri. Në këtë kontekst, unë mund të them se NATO-ja është një aleancë në reformim, është një aleancë në zgjerim dhe Shqipëria pret e vendosur të përmbushë kriteret e saj, që në samitin e ardhshëm, që do të vendosë për zgjerimin, të marrë ftesë. Ne duam të garantojmë vendet anëtare të NATO-s dhe vendet partnere se jemi shumë të vendosur të ndërmarrim çdo hap, të paguajmë çdo çmim për të merituar anëtarësimin e plotë në Aleancën e Atlantikut të Veriut, duke qenë të bindur se kjo është e ardhmja më e sigurtë, e ardhmja e sigurisë më të madhe të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

“NE MBESHTESIM ASPIRATAT EURO-ATLANTIKE TE SHQIPERISE DHE FQINJEVE TE SAJ”

Marsie Ries

Ambasadore e SHBA në Shqipëri

Eshtë një kohë emocionuese të mblidhemi këtu për të diskutuar për NATO-n dhe të ardhmen e Shqipërisë brenda Aleancës sonë. Gjatë javëve të fundit Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në procesin e integritit në Bashkimin Evropian duke sigluar Marrëveshjen e Stabilizim-Associimit; Vendet e Kartës së Adriatikut – Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia – mbajtën një takim të rëndësishëm partneriteti në Uashington; Admirali Ulrich i Komandës së Përbashkët Aleate në Napoli dhe Kryeministrat e Kroacisë dhe Maqedonisë vizituan Shqipërinë, dhe dje një delegacion i kryesuar nga Ambasadorja jonë në NATO, Victoria Nuland, vizitoi Tiranën për të diskutuar mbi aspiratat e Shqipërisë për NATO-n.

Por, sigurisht, bashkimi me Aleancën ka të bëjë me shumë më tepër se sa takime dhe vizita, prandaj unë dëshiroj ta shfrytëzoj këtë mundësi për të reflektuar në lidhje me NATO-n, se si ajo po ndryshon, vlerat që qëndrojnë në thelb të Aleancës dhe se çfarë do të thotë kjo për vendet që kërkojnë anëtarësim.

NATO është një organizatë në zhvillim, siç e tha me shumë elokuencë edhe Kryeministri. Dhe kjo jo vetëm se ka pranuar anëtarë të rinj – dhe kjo derë mbetet e hapur – por gjithashtu për shkak se është duke iu përshtatur sfidave të reja.

Gjatë Luftës së Ftohtë, roli thelbësor i NATO-s ishte që të ofronte një rrip sigurie që mundësoi zhvillimin ekonomik dhe demokratik në Europën Perëndimore e cila përballej me një armik agresiv dhe keqdashës. Gjatë viteve 90-të, NATO veprroi për t’iu dhënë fund konflikteve etnike tragjike në Ballkan dhe për të mbrojtur paqen. Ne patëm misionin paqeruajtës të Aleancës KFOR, dhe në gusht të vitit 2003, NATO ndërmori drejtimin e Forcës Ndërkombëtare të Ndhmës për Sigurinë në Afganistan, në operacionin e saj të parë jashtë zonës euro-atlantike.

Ndërkohë që NATO-ja e epokës së Luftës së Ftohtë nuk realizoi asnjë dislokim ushtarak, vitin që shkoi Aleanca u përfshi në tetë operacione ushtarake në mbarë globin.

Aktualisht, Aleanca është duke drejtuar një operacion paqeruajtës të ndërlikuar dhe të mbushur me sfida në Afganistan, ku merr pjesë edhe Shqipëria; po i ofron mbështetje logjistike Bashkimit Afrikan në Darfur; po ndihmon në train-

imin e forcave të sigurisë në Irak; dhe po dërgon ndihma humanitare përmes një ure ajrore në Pakistan.

Kështu, NATO-ja e sotme është një organizatë shumë e ndryshme nga ajo që mbrojti Europën Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara gjatë Luftës së Ftohtë.

Kërcënimet që paraqesin terrorizmi, shtetet e paqëndrueshme, përhapja e armëve dhe krizat humanitare janë mjaft të ndryshme nga ato të Luftës së Ftohtë. Dhe kjo është arsyeja pse NATO është e përfshirë në një proces transformimi. Për t'iu bërë ballë këtyre sfidave duhen mjete të ndryshme, si për çdo vend anëtar në veçanti, ashtu edhe së bashku si një Aleancë.

Kjo kërkon një numër të ri aftësish të ndryshme nga ato që nevojiteshin gjatë Luftës së Ftohtë, me theksimin më tepër të aftësisë për t'u dislokuar me shpejtësi dhe në operacione paqeruajtëse në vend të mbrojtjes territoriale. Kjo është arsyeja pse NATO do të mbajë një samit transformimi në Rigë në fund të këtij viti. Prandaj, planet e vendeve aspirante për reformën ushtarake duhet të përqëndrohen në plotësimin e kërkesave për shekullin e 21 dhe jo atë të 20.

Pika tjetër që unë dëshiroj të paraqes në lidhje me NATO-n është që kjo organizatë nuk është vetëm një aleancë ushtarake. Ajo që i lidh së bashku anëtarët e Aleancës janë besimi ynë i përbashkët në një numër vlerash të përcaktuara qartë si liria, respekti për të drejtat e njeriut, qeverisja demokratike, shteti i së drejtës dhe parimet e tregut të lirë. Këto janë vlerat që e udhëhoqën Aleancën përgjatë Luftës së Ftohtë dhe ato vazhdojnë të qëndrojnë në thelbin e saj. Në Këshillin e Atlantikut Verior vendet që ndajnë vlera të përbashkëta takohen për të diskutuar sfidat me të cilat përballen në botë dhe përipiqemi të vendosim se ç'loj veprimesh nevojiten.

Unë nuk kam asnjë dyshim që Shqipëria dhe fqinjët e saj ndajnë përkushtimin e NATO-s ndaj lirisë, paqes dhe stabilitetit, sepse ju e dini shumë më mirë se çdo të thotë të jetosh pa to. Por, hyrja në Aleancë do të thotë gjithashtu të punosh, dhe, krahas reformave ushtarake, kërkon reforma politike, institucionale dhe ekonomike. Është shumë e vërtetë, lufta kundër krimit dhe korrupsionit është gjithashtu një pjesë e rëndësishme dhe e domosdoshme e axhendës së reformave, një pjesë që do të kërkojë angazhim jo vetëm nga qeveria, por edhe nga shoqëria si e tërë në mënyrë që të ketë sukses.

Po kështu, reforma ushtarake kushton dhe duhet që t'i jepen burimet e nevojshme. Është po kaq e rëndësishme që këto burime të përdoren me maturi. Është gjithashtu e rëndësishme që të jemi realistë mbi atë që është e mundur: cilësia ka shumë më tepër rëndësi se sasia. Shqipëria është një vend i vogël, por, pavarësisht nga kjo, në Afganistan dhe Irak ka demonstruar se mund të luajë një rol që shkon përtej përmasës së saj fizike.

Unë shpresoj që, duke pasur parasysh dhe mbështetjen e gjerë që integrimi në NATO dhe BE gëzon në popullin shqiptar dhe tërë spektrin politik, ju do të mund ta përdorni këtë konsensus si bazë për të punuar mbi gjërat që duhet të bëhen për të përmbushur standardet e Aleancës.

Ne mbështesim aspiratat euro-atlantike të Shqipërisë dhe fqinjëve të saj

sepse ju jeni miqtë tanë, sepse ju ndani vlerat tona, dhe sepse ju mund të jepni një kontribut të vërtetë për një NATO në lëvizje; një NATO e cila përmes transformimit do të jetë më e fortë dhe më e përgatitur për t'u përballur me sfidat e nesërme të sigurisë.

Për herë të parë që nga rënia e Murit të Berlinit dhe ndoshta për herë të parë në histori, dhe falë në një pjesë të madhe premtimit të integritetit euro-atlantik, demokracia, paqja, begatia dhe sovraniteti janë qëlime plotësisht të realizueshme për Shqipërinë dhe fqinjët e saj në Europën Juglindore. Sfida është e qartë, por suksesi varet nga ju.

“BASHKEPUNIMI RAJONAL NE KUADER TE INTEGRIMT NE NATO”

Jarko Darkovski
Ambasador i Kroacisë në Shqipëri

Më është kërkuar të flas në këtë konferencë mbi bashkëpunimin rajonal, me theksin te bashkëpunimi SHBA - Kartë e Adriatikut.

Për të folur mbi Kartën duhet së pari t'i përgjigjemi pyetjes pse dëshirohet anëtarësia në NATO. Mendoj se nga një kënd më i gjerë duhen marrë në konsideratë tri çështje fundamentale:

Së pari, tipari i botës së sotme – një botë që përshkruhet si globale, që kërkon bashkëpunim të ngushtë të grupeve të vendeve. Bashkëpunim nuk do të thotë vetëm të marrësh, por edhe të japësh, ose më mirë të japësh kontribut në mënyrë që të marrësh.

Së dyti është tipari i sfidave të sotme ndaj sigurisë – ne jetojmë në një botë të ndryshme nga e djeshmja që ishte bota e ndarjes dhe e konfrontimit global. Por bota e sotme nuk është e sigurtë me shfaqjen e terrorizmit global, sigurisë së butë asimetrike dhe të tjera kërcënimeve me të cilat duhet të merremi. Asnjë shtet nuk mund ta bëjë këtë i vetëm dhe i duhet të bashkëpunojë me të tjerët, në nivele të ndryshme ndërkombëtare.

Së treti duhet ta marrim parasysh se e ardhmja e vendeve evropiane është në duart e tyre, por përcaktohet edhe nga mjedisi, i cili është thelbësisht i përcaktuar nga BE dhe NATO, si shtyllat e zhvillimit evropian, stabilitetit dhe sigurisë, bazuar në vlerat demokratike. Të jesh i ulur në tryezën e tyre, do të thotë të japësh ndihmesën e konfigurimit të të ardhmes tënde të sigurtë.

Kroacia po zhvillohet si një vend demokratik dhe me ekonomi tregu për t'i garantuar qytetarëve tanë standartet më të mira evropiane për jetët e tyre. Si një vend demokratik natyrisht që ajo dëshiron të marrë vendin e saj midis vendeve që ndajnë të njëjtat vlera dhe parime dhe të punojë së bashku me ata për të garantuar shanset më të mira të mundshme për zhvillim të qëndrueshëm dhe të sigurtë. Kështu, Kroacia ka vendosur si një prej qëllimet më të larta kombëtare të arrijë anëtarësinë në BE dhe NATO. Kjo vlen edhe për Shqipërinë dhe Maqedoninë dhe për vende të tjera, jo vetëm në këtë zonë të Evropës.

Proceset e integritimeve në BE dhe NATO kanë rrugët e tyre, por kanë themele të përbashkëta – vlerat dhe parimet e demokracisë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, ekonomia e tregut etj. Ato gërshetohen të krijojnë Evropën e njësuar dhe të lirë të së nesërme. Dhe, çfarë harrohet shpesh, të hysh në një klub nuk

është thjesht regjistrimi në të, por gjithashtu duhet të pranohesh prej anëtarëve të tjerë. Prandaj vendimi mbi zgjerimin e këtyre organizatave është gjithmonë politik. Sido që të arrihet anëtarësimi, ai është përherë individual – ka të bëjë me një vend dhe me vendet anëtare.

Integrimi evropian dhe transatlantik shkon krah për krah me bashkëpunimin rajonal. Çdo bashkëpunim rajonal që të jetë i suksesshëm duhet të orientohet nga e ardhmja. Me fjalë të tjera, veçanërisht në këtë pjesë të Evropës, ai duhet bazuar mbi vlera evropiane dhe të jetë funksionalisht pjesë e proceseve integruese euro-atlantike.

Të bashkëpunosh rajonalisht në nivele politike, ekonomike, kulturore dhe në nivele të tjera, do të thotë të realizosh qëllime të përbashkëta me fqinjin tënd – mirëkuptim më të mirë ndërmjet dialogut politik, projekteve të përbashkëta, si ato për zhvillimin e korridoreve evropiane 5, 7, 8 dhe korridori i ardhshëm Adriatik-Jon; transmetime energjie, etj.; të krijosh një Zonë të Tregëtisë së Lirë, për të cilën në mendojmë se CEFTA e modernizuar dhe e përshtatur është zgjidhja më e mirë; të luftosh problemet rajonale si korrupsioni, krimi i organizuar, trafikimi, migrimet jologjore; pashmangshmërisht të këputen lidhjet e terrorizmit ndërkombëtar dhe në mënyra të tjera të rrisësh nivelin e sigurisë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, etj. Të ndash të njëjtat vlera, përshirë ato të nxitjes së stabilitetit rajonal, është thelbësore që bashkëpunimi rajonal të zhvillohet vërtet dhe ka një përparim konstant në këtë fushë qëkur të gjitha vendet e Evropës Juglindore kanë zgjedhur reforma të brendshme demokratike, anëtarësinë në BE dhe NATO, dhe të bashkëpunojnë me bashkësinë ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjeve serioze të mbetura të hapura në këtë zonë të Evropës. Megjithatë niveli i reformave nuk është i barabartë. Procesi i integritit i shteteve në rajon, sipas arritjeve dhe meritave individuale, është pjesë e procesit të njëjtë të futjes së Evropës Juglindore brenda BE dhe NATO-s. Kjo sinerji dhe ndërvarësi midis reformave të brendshme, bashkëpunimit rajonal dhe integritit evropian dhe euro-atlantik është shumë e rëndësishme.

Që prej mbarimit të Luftës së Ftohtë, NATO ka kaluar nëpër procesin e rivlerësimit të rolit dhe vendit të saj dhe ka përcaktuar rolin e vet të ri për shek. XXI. Ajo që u krijua fillimisht is një organizatë mbrojtëse tashmë është një organizatë e sigurisë e klasit të parë. NATO mishëron edhe një tipar shumë të rëndësishëm – idenë e lidhjeve të vazhdueshme midis Evropës demokratike dhe shteteve të Amerikës së Veriut, veçanërisht ndihmesa që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë dhe i japin sigurisë dhe stabilitetit evropian. Me kalimin e viteve NATO ka zhvilluar kapacitete, përvoja dhe aftësi, të cilat i kanë shërbyer dhe i shërbejnë, në një mënyrë racionale, sigurisë kombëtare dhe kolektive të anëtarëve të saj.

Pas raundit të fundit të zgjerimit, vetëm tri vende që janë përfshirë në forma të larta të integritit në NATO – duke patur Planin e Veprimit të Anëtarësisë – nuk janë bërë anëtarë të saj. Kroacia, Shqipëria dhe Maqedonia vendosën të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të shpejtuar procesin e integritit të tyre në NATO, me anë të bashkëpunimit të tyre në frymën e Grupit Vilnius dhe në

kuadër të Planit të Veprimit të Anëtarësisë. Gati tri vite më parë, ato u bashkuan më SHBA, duke ndjekur përvojën e ngjashme të mëparshme të vendeve baltike dhe formuan Kartën SHBA-Adriatik. Karta, e nënshkruar më 3 maj 2003, e fton Aleancën të vlerësojë secilin vend sipas arritjeve individuale, nënvizon rëndësinë e forcimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut dhe pakicave dhe luftën kundër terrorizmit, krimit ndërkufitar dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Ajo nxit vazhdimin e reformave të forcave të mbrojtjes në të tri vendet, si edhe bashkëpunimin e tyre ushtarak.

Karakterit, fusha dhe niveli i bashkëpunimit brenda Kartës janë të gjera dhe variojnë prej takimeve të përfaqësuesve të larë qeveritarë, takime të ekspertëve, deri në stërvitje ushtarake. Bashkëpunimi i sigurisë dhe ushtarak është aspekti më i rëndësishëm i bashkëpunimit midis tri vendeve. Rezultati më i prekshëm i bashkëpunimit është Ekipi Mjekësor i vendosur në Afganistan, brenda Misionit ISAF. Këtë vit 34 aktivitete të ndryshme do të zhvillohen, kryesisht në fushën e bashkëpunimit ushtarak. Njëra prej stërvitjeve, "ARIEX 06", synon të ngrejë aftësitë në luftën kundër përhapjes së Armëve të Shkatërrimit në Masë.

Udhëzimet politike për bashkëpunim janë të vendosura nga Komisioni i Partneritetit, i cili mblidhet një apo dy herë në vit. Takimi i fundit i Komisionit ishte në Uashington më 13 shkurt, kur ministrat e punëve të jashtme të A3 u takuan me Sekretaren e Shtetit Rice dhe diskutuan në detaje shumë çështje kryesore me Nënsekretarin Burns dhe të tjerë zyrtarë të lartë amerikanë.

Një tjetër takim i rëndësishëm politik këtë vit do të jetë ai midis Adriatik 3 dhe Balltik 3, që do të mbahet nga fundi i prillit në Kroaci, me pjesëmarrje amerikane. Kjo do të jetë një mundësi e shkëlqyer për shkëmbimin e përvojave midis këtyre vendeve - kandidatë dhe anëtarë të NATO-s.

Bashkëpunimi A3 gjithashtu i hapur ndaj pjesëmarrjes së shteteve të tjera rajonale, Serbia dhe Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina. Këta vende që kanë statusin e vëzhguesit në A3, gëzojnë mbështetjen tonë konstante për t'u bashkuar me Partneritetin për Paqe, sipas kriterëve të vendosura dhe reformat e tyre të mbrojtjes të arrijnë anëtarësinë në NATO.

Bashkëpunimi brenda Kartës, veçanërisht meqë përfshin fushat e ndjeshme të sigurisë dhe mbrojtjes, jep ndihmesë në zhvillimin konstant të mirëkuptimit dhe mirëbesimit midis anëtarëve dhe në rajon.

Natyrisht, Karta nuk është forma apo aktiviteti i vetëm me anë të të cilit Kroacia, Shqipëria dhe Maqedonia janë duke kontribuar në thellimin e paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale. Ato janë duke e arritur këtë nëpërmjet zhvillimit të tyre të qëndrueshëm, demokratik individual, nëpërmjet bashkëpunimit bilateral, aktiviteteve të tyre në forume rajonale their activities in regional forums, zhvillimit të marrëdhënieve miqësore sa më të gjera të mundshme në rajon. Të tria vendet janë duke kontribuar në misionet paqeruajtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe NATO-s në shumë pjesë të botës, duke provuar që nuk janë konsumatorë por kontribues të sigurisë ndërkombëtare.

Ky është një vit vendimtar për Evropën Juglindore dhe të tria vendet do të kenë një rol aktiv në mbështetjen dhe ndihmesën ndaj BE, NATO dhe Komunitetin Ndërkombëtar në lidhje me çështet kryesore në zonë: – statusi i Kosovës, referendumi në Mal të Zi dhe ndryshimet kushtetuese në Bosnjë-Herzegovinë.

Arritjet dhe kontributet e të tri vendeve janë dëshmuar nga negociatat e Kroacisë për hyrjen në BE, statusi i kandidatit i Maqedonisë për anëtarësi në BE dhe nisja e MSA nga Shqipëria.

Të tria vendet përpara samitit të këtij viti në Rigë i kanë shpeshtuar aktivitetet e tyre individuale dhe kolektive dhe presin që partnerët e NATO-s të haoin rrugën për përfshirjen e Kroacisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë në NATO, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se viti 2008, kur pritet të zhvillohet samiti tjetër i NATO-s. Ky është mesazhi i qartë dhe i fortë që tri kryeministrat kanë dërguar kohët e fundit nga takimi i tyre informal në Durrës, më 28 shkurt.

“KARTA E ADRIATIKUT DHE NATO”

*Besnik Mustafaj
Ministër i Jashtëm i Shqipërisë*

Eshtë kënaqësi e veçantë për mua t’i drejtohem kësaj Konference të Rëndësishme, për të prezantuar pranë jush momentet më kryesore të bashkëpunimit në kuadër të Kartës së Adriatikut. Me këtë rast, falenderoj thellësisht organizatorët, jo vetëm për ftesën, por dhe për vëmendjen që ata i kushtojnë procesit të integritimit të vendit në strukturat euro-atlantike.

Të gjithë vërejmë se mjedisi strategjik në Europë është ende në fazën e transformimit, një transformim që prek në përgjithësi aspektet politike, ushtarake, ekonomike, njerëzore, shoqërore, të ambientit dhe të informacionit. Rrjedhimisht, një arkitekturë e re e sigurisë po përvijohet, ku NATO do të vazhdojë të kontribuojë në mënyrë përcaktuese në ndërtimin e një sistemi kolektiv, por plotësisht efektiv, të sigurisë dhe stabilitetit, duke ruajtur dhe fuqizuar lidhjen jetike Transatlantike, shtyllë kjo e pazëvendësueshme jo vetëm për sigurinë euroatlantike, por do të thosha gjithnjë e më shumë për sigurinë e mbarë planetit. Në këtë koncept, ndërtimi i një Europe demokratike dhe të integruar, pa kufij ndarës, është vizioni i përbashkët udhëheqës. Pa dashur të zgjatem në numërimin e të gjithë elementeve kryesore që promovojnë paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon, do të doja të nënvizoja njërën prej tyre, që ka edhe rëndësinë më të madhe në temën që po trajtojmë sot, atë të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal në funksion të proceseve integruese që përjeton rajoni.

Në zhvillimin dhe përsosjen e këtyre vlerave Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia mbështetur në përvoja të mëparshme të suksesshme të rajoneve të ngjashme dhe nën kujdesin e veçantë të SHBA-së, kanë ndërmarrë një nismë partneriteti, e cila tashmë është e mirënjohur, si nga faktori vendas, ashtu dhe nga ai ndërkombëtar. Kjo iniciativë shërben si një instrument që do të përshpejtojë hyrjen e vendeve tona në NATO, sepse ne, ashtu si dhe partnerët tanë në NATO, besojmë se bashkëpunimi rajonal përbën një vlerë të shtuar për Aleancën.

Vlerësoj, se vendet e Ballkanit janë pjesë integrale e Europës dhe se procesi i unifikimit të kontinentit tonë do të quhet i përfunduar vetëm atëherë kur vendet e këtij rajoni do të jenë pjesë përbërëse e Bashkimit Europian dhe NATO-s. Në këtë këndvështrim, zgjerimin e Aleancës në Europën Juglindore e quaj një proces të natyrshëm, i cili jo vetëm do të forcojë krahun juglindor të NATO-s, por edhe do të ndihmojë drejtpërsëdrejti në forcimin e demokracisë, paqes, stabilitetit, ekonomisë së tregut dhe shtetit ligjor në rajon.

Karta e Partneritetit e ka konfirmuar plotësisht veten si një kuadër i përshatshëm për ta rritur dhe harmonizuar bashkëpunimin midis tri vendeve tona. Ky progres vlerësohet i lidhur ngushtë me evoluimin pozitiv të shoqërive dhe institucioneve në vendet e A-3. Zhvillimet e natyrshme demokratike po sjellin përditë pjekurinë e klasës politike dhe të shoqërisë civile, duke u çelur rrugën projekteve kombëtare realiste dhe në respekt gjithnjë e më të denjë të vlerave njerëzore. Vizione perëndimore të veprimit dhe reformave, përqaftuar tashmë nga politika dhe mbarë shoqëritë tona, na bëjnë ne gjithnjë e më shumë pjesë të vlerave themelore mbi të cilat mbështeten strukturat Euro-Atlantike.

Dinamizimi i marrëdhënieve tona në kuadër të Kartës së Partneritetit ka përmirësuar ndjeshëm perceptimin e fqinjësisë. Shkëmbimi i eksperiencave kombëtare në kuadër të Kartës së Adriatikut, në fusha të ndryshme të sigurisë, si ajo e mbrojtjes përmes takimeve në format Ministra Mbrojtjeje, Shefa Shtabi, ekspertësh dhe përmes organizimit të stërvitjeve të përbashkëta si dhe në fushën e sigurimit të informacionit të klasifikuar, përmes vizitave të ekspertëve dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të përbashkëta, kanë prodhuar një reagim më adekuat ndaj sfidave të terrorizmit ose krimit të organizuar që ushtron kryesisht trafikun e drogës dhe të qenieve njerëzore. Shkëmbimi i Dokumentave të Programit Kombëtar Vjetor të Antarësimit në NATO dhe aktivitetet e përbashkëta në fushën e mbrojtjes dhe në atë të shërbimit kufitar janë një shembull domethënës i transparencës dhe besimit të ndërsjellë të kontribute pozitive.

Në zbatim të politikës së saj konstruktive në rajon, tashmë të njohur dhe vlerësuar në mjaft takime të niveleve të larta NATO-Shqipëri dhe deklarata të zyrtarëve të lartë ndërkombëtarë, Shqipëria po mbështet me të gjitha mundësitë zgjidhjet paqësore të problemeve. Gjykuar me mentalitetin bashkëpunues, duke ndjekur normat bashkërisht të miratuara në Kartën e Partneritetit, në përputhje me principet e vetë Aleancës, ne mbështesim aspiratën e Bosnje dhe Hercegovinës si dhe të Unionit Serbi-Mal i Zi për t'u përfshirë në Programin e Partneritetit për Paqe, sapo ata të plotësojnë standartet e nevojshme.

Bashkëpunimi në kuadër të Kartës së Partneritetit ka mundësuar që vendet tona të reagojnë në mënyrë konkrete në mbrojtje të sigurisë përtej caqeve të rajonit tonë. Shqipëria së bashku me Maqedoninë dhe Kroacinë kanë dërguar Skuadrën e Përbashkët Mjeksore në Afganistan. Njëkohësisht, në cilësinë e Kryesisë së Sekretariatit të rradhes së SEDM-CC/PMSC (Ministeriali i Mbrojtjes së Europës Jug-Lindore - Komiteti Koordinativ/Komiteti Drejtues Politiko -Usharak), Shqipëria ndikoi ndjeshëm në marrjen e vendimit për të realizuar dislokimin e Komandës së SEEBRIG-ut në Afganistan.

Ministria e Punëve të Jashtme po ndjek me vëmendjen më të madhe debatin mbi përgatitjen e dy Samiteve të ardhshme të NATO-s. Është shumë e rëndësishme që Aleanca dhe vendet e saj anëtare të përcaktojnë sa më shpejt një kuadër të qartë të kalendarit të zgjerimit. Pavarësisht nga reformimi që Aleanca pritet të ndërmarrë në Samitin e 2006-s, unë besoj seriozisht se nuk do të vihet në dyshim parimi i "Dyerve të Hapura", dhe gjej arsye të mjaftueshme për të

pritur ftesën për anëtarësim në Samitin e 2008, ftesë kjo që do të na inkurajonte më shumë se çdo gjë tjetër për të thelluar reformat demokratike, që do ta bënin vendin tonë të denjë për të qenë anëtar i Aleancës.

Eshtë shumë i rëndësishëm fakti që të tre Ministrat e Punëve të Jashtme, në takimin e Komisionit të Partneritetit të Kartës, zhvilluar në Washington më dt. 13-14 shkurt 2006, kërkuan që Aleanca dhe vendet e saj anëtare të përcaktojnë sa më shpejt një kuadër të qartë të kalendarit të zgjerimit. Pavarësisht nga reformimi që Aleanca pritet të ndërmarrë në Samitin e 2006-s, kemi marre angazhimin dhe premtimin e zyrtarëve më të lartë të administratës amerikane dhe të partnerëve tanë europianë, se në Samitin e 2008, duke përbushur të gjitha objektivat e partneritetit dhe realizuar me sukses reformën në fushën e mbrojtjes, vendi ynë do të marrë ftesën për anëtarësim në Aleancë. Ndërkohë, qeveria shqiptare mbetet e angazhuar për të shtuar komunikimin me qeveritë e vendeve që përcaktojnë vendim-marrjen në Aleancën e Veriut. Takimi i Ministrave të Jashtëm dhe të Mbrojtjes të vendeve të Kartës së Partneritetit me homologët e vendeve Balltike, që do të zhvillohet në Kroaci në muajin prill 2006, do të shërbejë si një mundësi e mirë për të nxitur mbështetjen e këtyre vendeve në funksion të procesit të anëtarësimit të vendit në NATO.

Në këtë paraqitje të përmbledhur të përpjekjeve tona e gjej me vend të theksohet dhe rëndësia që po merr kontrolli parlamentar mbi ecurinë e procesit për antarësimin e vendit në NATO. Parlamenti shqiptar po luan një rol gjithnjë e më thelbësor në monitorimin e zbatimit të programeve dhe reformave të domosdoshme për standartet Euro-Atlantike. Jam i sigurtë se pa këtë rol të Parlamentit nuk do të kishim në Tiranë e në mbarë Shqipëri një ambjent kaq favorizues për antarësimin drejt Aleancës së Atlantikut të Veriut. Ka ardhur koha të koordinojme punën për vizita të përbashkëta të parlamentarëve të tri vendeve tona në Kongresin Amerikan. Ne jemi dëshmitarë të rëndësisë që luajti Akti Solomon i Senatit Amerikan për 7 vendet që morën ftesën në Samitin e Prages. Ne kemi përshëndetur Rezolutën 558 të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan, për nxitjen që ajo i dha vendeve anëtare të NATO-s ndaj aspiratës sonë. Ne do të mirëprisnim çdo iniciativë të Kongresit që do të ndihmonte tri vendet tona ta përshkonin më shpejt distancën që i ndan nga "Dera e Hapur" e Aleancës, objektiv që mund të bëhet i mundur vetëm me përkrahjen dhe ndihmën e parlamentarëve tanë dhe me një punë serioze, të programuar dhe të bashkërenduar me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe homologët e parlamenteve të vendeve të Kartës së Partneritetit.

Në mbyllje, në vlerësim të ftesës për të kontribuar në këtë konferencë, dëshiroj të ritheksoj rëndësinë e organizimit të këtyre aktiviteteve dhe veçanërisht pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile dhe të rinisë, pa të cilën nuk do të realizohet përkrahja dhe mbështetja e publikut të gjerë vendas, që është edhe kushti bazë për një ecje të shpejtë dhe të sigurtë drejt anëtarësimit të plotë të Shqipërisë në NATO.

“SFIDAT POLITIKE TE SIGURISE”

Leonard Demi

Kryetar i Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare

Tranzicioni demokratik dhe integrimi euroatlantik, lëvizja e lirë e njerëzve, e të mirave materiale, shërbimeve, parave dhe informacionit e kanë futur Shqipërinë në një proces të ri, i cili nuk është vetëm një dukuri apo një prirje kalimtare. Ky është sistemi ndërkombëtar që zëvendësoi sistemin e Luftës së Ftohtë, pjesë e të cilit ishim edhe ne.

Kërcënimet kryesore me të cilat përballemi sot në rrafshin e brendshëm janë: krimi i organizuar, korrupsioni. Trafiqet e paligjshme (drogë, armë, njerëz,,), terrorizmi, fatkeqësitë natyrore etj. Në rrafshin e jashtëm ato janë: krimi i organizuar, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, terrorizmi, konfliktet rajonale, etj.

Sigurinë dhe përparimin e Shqipërisë ne i shohim të lidhur me institucionet euroatlantike, prandaj, më parë se të gjitha vendet e Europës Lindore, kërkuam anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe në BE, dhe sot po intensifikojmë përpjekjet për një integrim të shpejtë në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Këto përpjekje synojnë një përparim paralel në fushat politike dhe ekonomike, ushtarake, të burimeve, në fushën legjislative, dhe të sigurisë së informacionit. Mjeti dhe menyra për realizimin e tyre janë Plani Kombëtar i Veprimit për Anëtarësim, Programi Individual i Partneritetit, Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit të Forcës, plotësimi i Objektivave të Partneritetit, pjesëmarrja aktive në stërvitjet e përbashkëta dhe në misione në mbështetje të paqes, si: operacioni ALTHEA, ISAF dhe Liria e Irakut.

Reformat në forcat tona të armatosura

Reformat në Forcat tona të Armatosura (FA), që pasqyrohen në Planin e Veprimit për Anëtarësim dhe në planin afatgjatë, kanë për qëllim të krijojnë një forcë ushtarake të vogël në numër, shumë operationale, profesioniste dhe të ndërveprueshme me forcat e Aleancës. Këto reforma po përparojnë sipas një programi të hollësishëm, ku të gjithë përbërësit si: doktrinën dhe procedurat standarde, njësitë, kapacitetet dhe pajisjet, strukturat, misionet, etj., konceptohen dhe realizohen si elemente të përbashkët të të njëjtit sistem. Sipas kësaj strategjie që po zbatohet nga të gjitha strukturat shtetërore, Forcat Tokësore përmirësojnë infrastrukturën dhe rrisin aftësitë operationale, sidomos të njesive

prioritare (Brigadës së reagimit të Shpejtë, Regjimentit Komando dhe Brigadës së Xhenios). Ato do të vazhdojnë të kontribuojnë në operacione humanitare në raste emergjencash civile apo në projekte të infrastrukturës kombëtare, si dhe në misione ndërkombëtare në mbështetje të paqes. Forcat Detare synojmë t'i pajisim me anije patrulluese shumërolëshe e me sistem të vëzhgimit të hapësirës detare. Këto forca do të zgjerojnë bashkëpunimin në kuadër të nismave rajonale (si Adrion) dhe në operacione të përbashkëta, etj. Forcat Ajrore kanë stacionuar avionët me krahë fiks dhe do të rrisin numrin e helikopterëve dhe kapacitetin e Qendrës Operacionale të Sovranitetit.

Vëmendje po i kushtohet raportit organikë-kapacitete, mision-strukturë rezervë me pikësynimin mënjanimin e dublimeve strukturore në gjithë sistemin e FA dhe çlirimin e tyre nga infrastukturat dhe objektet e tepërta. Ne po eliminojmë forcat rezerviste dhe strukturat intelektuale do të zëvendësohen nga komanda të vogla me personel aktiv.

Pajisjet e reja ushtarake do të vlerësohen sipas cilësisë, jetëgjatësisë dhe interperabilitetit të tyre. Në këtë kontekst, kujdes i posaçëm po i kushtohet sigurimit të kapaciteteve të nevojshme për të përballuar fatkeqësitë natyrore.

Prioritete të planit të modernizimit janë:

- Sistemi i Integruar i Vëzhgimit Kombëtar, duke filluar nga ndërtimi i Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare, i cili do t'u shërbejë edhe dikastereve të tjera që u nevojitet informacion për emergjencat;
- Sistemi C4I (komandim, drejtim, komunikim, kompjuterizim, zbulim dhe lëvizshmëri e trupave);
- Helikopterët për operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR), helikopterët e transportit, si dhe rritja dhe mirëmbajtja e kapaciteteve riparuese;

Komanda e Mbështetjes Logjistike ka filluar punën për hartimin e një strategjie afatgjatë për të përmirësuar kapacitetin e mbështetjes logjistike dhe infrastrukturën e njësive dhe bazave tona. Përparësi e kësaj komande është pajisja dhe trainimi i grupit AME për ta bërë atë të aftë të marrë pjesë në operacionet e drejtuara nga NATO, në përputhje me kërkesat e Konceptit të Kapaciteteve Operacionale (OCC). Kujdes i veçantë po i kushtohet rritjes së kapaciteteve të nënrepartëve të PpP, me qëllim që disa syresh të rritin aftësitë operacionale dhe të çertifikohen nga NATO. Sipas parimit të OCC, sot kemi deklaruar dy njësi, të cilat presin çertifikimin e NATO-s. Gjatë këtij viti do të deklarojmë dhe dy njësi të tjera. Vëmendje e veçantë po i kushtohet përmirësimit të shërbimit shëndetësor dhe armëkontrollit.

Komanda e doktrinës dhe stërvitjes po rrit nivelin e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe pedagogjike në të gjithë qendrat dhe shkollat e veta. Dokumentat strategjike, tekstet mësimore për përgatitjen dhe kualifikimin e oficerëve po hartohen sipas standarteve të NATO-s. Këto botime do të pasqyrojnë edhe përvojën tonë të fituar nga pjesëmarrja në operacionet në mbështetje të paqes,

stërvitjet e përbashkëta, në operacionet humanitare, etj. Kështu, Akademia e Mbrojtjes po bën përpjekje serioze për të rritur cilësinë e kurrikulës në shkollën pasuniversitare të nivelit master me dy degë: Siguri kombëtare dhe Mbrojtje, si dhe në kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm. Akademia e nënoficerëve këtë vit do të përgatisë nënoficerë karriere në katër nivele: grup, skuadër, togë dhe kompani. Përpjekje serioze për rritjen e cilësisë edukative po bën, gjithashtu, Universiteti Ushtarak “Skënderbej” dhe qendra e gjuhëve të huaja. Përsa i përket qendrës stërvitore, ajo do të mbështetet më tej për të funksionuar me më shumë cikle.

Personeli i nevojshëm i FA po trajtohet sipas paketës ligjore dhe rregulloreve, të cilat saktësojnë rekrutimin, arsimin dhe stërvitjen, gradimin dhe karrierën. Kjo paketë përcakton edhe mënyrën e kalimit në rezervë të personelit ushtarak. Ushtarakët po trainohen vazhdimisht për të arritur standardet dhe po vlerësohen në bazë të aftësive profesionale. Ata që kanë arritur standarde të kënaqshme, gëzojnë mundësinë për të vënë në jetë përvojën e fituar. Kujdes po tregohet, gjithashtu, për përmirësimin e kushteve të jetesës së efektivave ushtarake.

Duke filluar nga ky vit, qeveria vendosi të rrisë buxhetin e mbrojtjes me 0,1% të PPB, me pikësynim arritjen e 2% të PPB, ashtu siç është parashikuar në dokumentin e Strategjisë Ushtarake. Parlamenti është i angazhuar të mbikqyrë shpenzimin e fondeve dhe realizimin e objektivave të zhvillimit dhe modernizimit të FA, sipas Planit të Veprimit për Anëtarësim dhe planit afatgjatë.

Legjislacioni ynë po qaset sipas legjislacionit të Aleancës dhe për të arritur nivelin e pranueshëm të sigurisë së informacionit, do të sigurojmë kushtet teknike dhe personelin e nevojshëm. Kujdes i veçantë po bëhet për trainimin e mëtejshëm të Autoritetit të Sigurimit Kombëtar.

Krahas përpjekjeve për t’u forcuar dhe modernizuar, FA po rrisin bashkëpunimin me Forcat e Ruajtjes së Rendit dhe Shërbimin Informativ Shtetëror, kundër krimit të organizuar, trafikimeve të paligjshme, duke përfshirë trafikimin e Armëve, kundër terrorizmit apo ndonië kërcënim tjetër që mund t’i bëhet Kushtetutës.

Bashkëpunimi rajonal në fushën e mbrojtjes

Problemet që mund t’i zgjidhim krejt vetëm, janë shumë pak. Kërcënimet që përshkruam më sipër janë të përbashkëta dhe i ndajmë me të gjithë partnerët tanë të ngushtë: BE (duke përfshirë edhe anëtarët), SHBA, me fqinjët dhe vendet demokratike me të cilët ndajmë të njëjtat vlera. Në drejtim të forcimit të sigurisë dhe të mbrojtjes të rajonit, përveç marrëdhënieve të ngushta dhe ndihmës së jashtëzakonshme që gëzojmë nga NATO, SHBA dhe BE, ne jemi thëllësisht të angazhuar të zgjerojmë më tej bashkëpunimin me vendet e rajonit. Jemi të bindur se kjo politikë i shërben stabilitetit afatgjatë dhe i jep gadishullit tonë mundësinë për t’u rikthyer në Evropë. Gjatë 50 vjetëve të shkuara mësuam se integrimi mbron besim, stabilitet dhe përparim. Bashkëpunimi ynë rajonal përfshin dy drejtime: dy dhe shumëpalësh. Bashkëpunimi shumëpalësh bëhet në kuadër

të SEDM-it, A3-it, ADRION-it, Paktit të Stabilitetit (Tryeza e tretë) dhe Qendrës së armëkontrollit rajonal.

Takimet e ministrave të Mbrojtjes së vendeve të Europës Juglindore (SEDM) ka ndikuar në rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, krijimit të kapaciteteve mbrojtëse rajonale, si brigada e Europës Juglindore. Inisiativa A3 apo karta e Adratikut ka thelluar këtë bashkëpunim, ka mundur stërvitjet e përbashkëta, pjesëmarrjen dhe kontributin në misionet e NATO-s, shkëmbim pervoje, etj. Iniciativa ADRION synon forcimin e sigurisë në rajon nëpërmjet bashkëveprimit dhe bashkëtrajnit të Forcave Detare të vendeve të rajonit (Itali, Greqi, Shqipëri, Bashkimi Serbi-Mali i Zi, Kroaci dhe Slloveni). Ndërsa Projekti Pilot i Qendrës Rajonale të Kontrollit të Trafikut Detar (V-RMTC) ka për qëllim të vendosë një lidhje ndërmjet qendrave operacionale të shteteve pjesëmarrëse dhe të shkëmbejë informacion josekret mbi anijet e transportit të pasagjerëve dhe të mallrave. Qendra e armëkontrollit, e cila funksionon në kuadër të Paktit të Stabilitetit dhe që ndodhet në Kroaci, synon të rrisë besimin dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit në fushën e sigurimit ushtarak.

Në planin dypalësh kemi nënshkruar me të gjitha vendet e rajonit marrëveshje, të cilat përfshijnë stërvitje të përbashkëta kombëtare dhe shumëkombëshe, si dhe vizita familjarizuese ndërmjet forcave të armatosura; ndihmë për kualifikim afatshkurtër dhe afatmesëm të personelit, shkëmbim pervoje dhe informacioni, asistencë për përmirësimin e mbështetjes logjistike, duke përfshirë edhe ndihmën mjekësore, etj. Me disa syresh bashkëpunimi është më i madh dhe përfshin ndihmën për ristrukturimin e Forcave tona të Armatosura, rritjen e kapaciteteve operacionale dhe përmirësimin e infrastrukturës së ushtrisë sonë, për fuqizimin e Rojes Bregdetare, hartimin e dokumentave kryesore dhe legjislacionit, etj.

Sfidat që duhet të kapërcejmë

Unë e shikoj të realizueshme këtë strategji në dy drejtime: në planin e brendshëm dhe atë të jashtëm. Në planin e brendshëm ajo realizohet nëpërmjet qeverisjes së mirë dhe forcimit të institucioneve, aftësisë dhe qëndrueshmërisë së tyre për të garantuar drejtimin demokratik të vendit, shtetin ligjor, zhvillimin ekonomik, luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme (drogë, armë, njerëz), kundër pastrimit të parave, terrorizmit, respektimin e të Drejtave të Njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve. Kesisoj “*acquis communautaire*”: ligjet ekzistuese, rregullat dhe marreveshjet e Bashkimit Evropian do të zbatohen edhe në vendin tone.

Potenciali ynë i sotëm është në lartësinë e kësaj strategjie, sepse ne zotërojmë kapacitetet e nevojshme për forcimin e shtetit ligjor dhe institucioneve. Sot, ne po japim kontributin tonë, i cili do të vijë gjithnjë e në rritje, në sigurinë dhe zhvillimin rajonal e më gjerë nëpërmjet aktivitetit politik, ekonomik, pjesëmarrjes aktive në operacionet për të mbështetur paqen, etj.

Një Shqipëri më e përparuar është në mundësitë tona, sepse politika, për-

pjekjet dhe potenciali i ynë japin mundësi që institucionet dhe strukturat të thjeshtohen, të bëhen të afta, efektive, të koordinojnë veprimtaritë duke mënjeluar dublimet. Ne do të jemi të suksesshëm, sepse e mbështesim realizimin e kësaj politike në zbatimin e shtetit ligjor, forcimin e institucioneve dhe në një qeverisje efektive. Ne do të jemi të suksesshëm se po bashkëpunojmë ngushtë me NATO-n, SHBA, BE, vendet e rajonit, si dhe me të gjithë vendet demokratike dhe organizmat ndërkombëtarë.

“NJE STUDIM MBI MARREDHENIET NDERKUFITARE NE NIVEL VENDOR”

*Prof. As. Dr. Dhimitër Doka,
Universiteti i Tiranës*

I. Kuptimi dhe rëndësia e zonave ndërkufitare

Bashkëpunimi ndërkufitar përbën një dukuri të vjetër për Evropën, por të re për Shqipërinë. Mund të jepen shumë shembuj të bashkëpunimit të hershëm në këtë drejtim, veçanërisht midis vendeve të Evropës Perëndimore, si p.sh. midis Gjermanisë dhe Francës, Gjermanisë dhe Zvicrës, Austrisë, Italisë dhe Zvicrës etj. Pas prishjes së kufijve të Lindjes ky bashkëpunim u zgjerua edhe me vendet e ish-blokut lindor, si midis Gjermanisë dhe Çekisë, Gjermanisë dhe Polonisë etj.

Në Shqipëri për një bashkëpunim i tillë nuk mund të bëhej fjalë deri në vitin 1990, kur kufiri ishte një barrierë e pakalueshme. Në këto kushte zonat kufitare nuk kishin ndonjë rëndësi zhvillimi, madje ishin akoma më të izolurara se pjesët e tjëra të vendit. Rëndësia e bashkëpunimit ndërkufitar për Shqipërinë dhe rajonin tonë në përgjithësi do të fillonte të kishte kuptim dhe të rritej vetëm me prishjen e kuptimit të mëparshëm të kufijve pas vitit 1990 e në vazhdim. Tashmë ajo vlerësohet si një mundësi dhe alternativë mjaft e mirë zhvillimi dhe sigurimi në rajon.

II. Eksperienca e punës së përbashkët shqiptaro-gjermane në studimin e zonave ndërkufitare

Bazuar në rëndësinë që paraqet bashkëpunimi ndërkufitar në zhvillimin dhe integrimin e vendeve dhe rajoneve të ndryshme, lindi edhe ideja për realizimin e një studimi të tillë në zonat kufitare të Shqipërisë me vendet e saj kufitare. Për këtë u shfrytëzua eksperienca e krijuar tashmë që prej shume vitesh në bashkëpunimin ndëruniversitar midis gjeografëve nga Shqipëria dhe atyre gjermanë. Në këtë mënyrë u bë e mundur që të sillen shembuj të një bashkëpunimi të tillë ndërkufitar midis Gjermanisë dhe vendeve të saj kufitare, si me Çekinë, Poloninë etj. Puna për realizimin e këtij studimi kaloi në disa faza, si:

Faza përgatitore për realizimin e studimit:

- mbështetja në studimet e mëparëshme të përbashkëta, si bazë për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit;
- gjetja dhe bindja e donatorëve për realizimin e studimeve te tilla;

- ngritja e rrjetit të bashkëpunimit dhe grupeve të punës;
- kualifikimi dhe trainimi i grupeve të punës;
- përzgjedhja e zonave të studimit.

Organizimi i punës për në terren:

- përgatitja e pyetsorit;
- ndarja e grupeve të punës;
- caktimi i personave dhe grupeve për t'u intervistuar;
- realizimi i intervistave në terren.

III. Rezultatet paraprake të punës në terren

1. Zonat kufitare të Shqipërisë kanë specifikat e tyre, ku veçojmë: pjesa më e madhe mbeten zona ndërshqiptare; kushte të vështira të relievit dhe infrastrukture e dobët; disnivele të dukshme në zhvillimin socio-ekonomik.
2. Megjithë lehtësirat, kufiri mbetet përsëri pengesë për zona të veçanta, sidomos me Greqinë.
3. Në krahasim me të kaluarën, janë shtuar megjithatë ndjeshëm komunikimet, aktivitetet, bizneset në zonat ndërkufitare.
4. Ekziston optimizëm dhe mundësira për një zhvillim më të mirë ndërkufitar.

IV. Tipare dalluese në zhvillimin e zonave kufitare të Shqipërisë

Avantazhet që jep qenia zonë kufitare janë: gjatësia e madhe e kufirit tokësor me Greqinë, Maqedoninë, Kosovën dhe Malin e Zi; kufi ndërshqiptar me lidhje të forta socio-ekonomike dhe shpirtërore; lidhjet e veçanta që ka krijuar historia e përbashket dhe ngjarjet e veçanta (rasti i Kosovës 1999); prania e minoriteteve si ure lidhëse dhe bashkëpunimi; potenciale të rëndësishme natyrore dhe humane në të dy anët e kufirit.

Problemet që vështirësojnë zhvillimin ndërkufitar janë: niveli i ulët i zhvillimit ekonomik në të dy anët e kufirit (përveç Greqisë); problemet e tranzicionit: rënie ekonomike, papunësia me mbi 30%, të ardhurat më të ulta se mesatarja e vendit (për Kukësin 60-70 lekë në ditë); mbi 40% e familjeve me ndihmë sociale, biznese të vogla e të mesme sa për të mbijetuar; në Kosovë dhe Maqedoni - gjendja ekonomike gjithashtu e vështirë, mungesë stabiliteti etj.; Greqia akoma e rezervuar në bashkëpunimin ndërkufitar; gjendja veçanërisht e vështirë e infrastrukturës në zonat ndërkufitare, vetëm lidhje rrugore dhe me vështirësi të mëdha; kalimet doganore të dominura nga importet; reliev i thyer e shpesh tepër malor në zonat ndërkufitare; ndarja gati 50-vjeçare e shqiptarëve nga të dy anët e kufirit me ndikim në zhvillime të ndryshme në mentalitet, traditë, besim etj.; vështirësitë që krijon legjislacioni në vendet përkatëse; kualifikimi i ulët i administratës për të zgjidhur problemet; roli pozitiv i doganave dhe zonave kufitare zbehet shpesh nga veprimet ilegale, evazioni fiskal, tregtia e fshehtë etj.

V. Bashkëpunimi i derisotëm është pozitiv dhe premtues, gjë që shprehet në:

- Qarkullimin e madh të njerëzve dhe mallrave. Aq e fuqishme është bërë kjo lidhje sa banorët në zonat e veçanta e gjejnë veten më të lidhur me zonën përtej kufirit (Prespa, Shishtavec, Kukës-Has-Tropojë, komunat në kufi me Malin e Zi etj.) sesa me krahinat brenda vendit;
- Tregtinë, kryesisht import produkteve ushqimore, bagëti, karburant etj., veçanërisht me Greqinë, Prizrenin, Gjakovën etj.;
- Punësimin në vendet kufitare: Greqi, Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi. Shqiptarët e zonave kufitare punësohen kryesisht në ndërtim, bujqësi, tregti etj.;
- Aktivitete të përbashkëta ekonomike, sociale, sportive etj.;
- Arsimit në pjesët kosovare, maqedonase, greke etj.;
- Shërbimin shëndetësor ndërkufitar;
- Lidhje martesore nga të dy anët e kufirit (p.sh. 40 raste vetëm nga Kruma me Kosovën);
- Festa të përbashkëta kombëtare dhe fetare etj.

VI. Shembuj konkretë të bashkëveprimit ndërkufitar:

Kapshtica është qendra më e rëndësishme e kalimit kufitar në pjesën juglindore të Shqipërisë. Në zonën e Prespës ka bashkëpunim intensiv individual dhe lokal ndërkufitar. Ka shembuj të shumtë bashkëpunimi midis Pogradecit dhe pjesës maqedonase të Liqenit të Ohrit. Fati i Shishtavecit në Qarkun e Kukësit lidhet me tregëtinë e vogël me zonën matanë kufirit. Në Morinë tashmë ka një qarkullim të madhe mallrash dhe njerëzish midis Shqipërisë dhe Kosovës: vetëm gjatë verës mbi 100 000 kalime drejt Shqipërisë dhe 70 000 kthime. Në këtë pikë doganore ka takime të përmuajshme midis doganierëve dhe policisë së dy anëve dhe kërkohet heqje e taksave doganore për produktet vendase. Në Krumë bashkëpunimi ndërkufitar është kryesisht individual dhe i paorganizuar. Kurse Tropoja dhe Gjakova funksionojnë tashmë si një njësi e vetme, aq të ngushta janë në këtë zonë marrdhëniet ndërkufitare. Në pjesën veri-perëndimore të vendit, Hani i Hotit dhe Muriqani janë arteriet kryesore të lidhjeve me Malin e Zi, ku e dyta shërben vetëm për kalimin e njerëzve.

VII. Shembuj bashkëpunimi nga ana tjetër e kufirit

Nismat për bashkëpunime ndërkufitare kanë gjetur përgjigje edhe nga ana tjetër e kufirit. Ideja e Eurorajonit midis Korçës, Follorinës dhe Manastirit është e mirëpritur. Në zonën e Korçës ka investime të shumta greke në zonën e Korçës. Rreth Ohrit bashkëpunimi i qeverisjeve vendore të Shqipërisë dhe Maqedonisë është në nivele të mira. Dragashi në Kosovë ka marrëdhënie të ngushta me zonën e Kukësit, aq sa kufiri ka mbetur formal. Megjithatë vështirësitë infrastrukturore janë të mëdha Prizreni tashmë është kthyer në qendrën më rëndësishme e bashkëpunimit ndërkufitar me Kosovën, sepse ia siguron treg blerje për shumë

shqiptare nga Kukësi, punësim, arsimim dhe jetesë për persona dhe familje nga Shqipëria. Bashkëpunimi ndërinstitucional mbetet i dobët. 90% të produkteve ushqimore Tropoja i merr në Gjakove, rreth 100 punëtorë nga Tropoja punojnë në Gjakovë, 80 nxënës mësojnë në Gjakovë etj. Ulqini dhe rrethinat e tij e konsideron bashkëpunimin me Shqipërinë shumë të dëshirueshëm dhe mbetet një potencial i rëndësishëm për të ardhmen.

VIII. Sfidat për të ardhmen:

Kudo në zonat ndërkufitare ekziston dëshira dhe optimizmi për një bashkëpunim më të mirë në të ardhmen, për favorizimin e të cilit nevojiten të merren disa masa. Më e rëndësishja është investimi në përmirësimin e infrastrukturës, e cila është faktor vendimtar për zgjerimin e lidhjeve ndërkufitare. Arteriet e pritshme rrugore janë Korridori 8, rruga Durrës-Kukës-Prishtinë, rruga e Arbrit (Tiranë-Peshkopi- Dibër), rruga Gjakovë - Alpe-Shëngjin. Funksionimi i aeroportit të Kukësit përmban shpresat dhe ëndrrat për një zhvillim më të mirë ndërshtetëror dhe rajonal me zonën përreth. Bashkëpunimi ndërkufitar nuk dëshirohet edhe sepse ai është pararendës i sigurisë, integritit rajonal dhe euro-atlantik.

“MARREDHENIET NDERKUFITARE NE ZONEN E SHKODRES”

*Gjovalin Kolombi,
Prefekt i Qarkut Shkodër*

Integrimi sa me i shpejtë i vendit tonë në NATO është një dëshirë e të gjithë ne shqiptarëve, por ne jemi të ndërgjegjshëm se ndërmjet dëshirës dhe realizimit të saj ka ende mjaft punë për të bërë. Në fjalën time do të përqendrohem në një kusht të rëndësishëm në tërësinë e kushteve që duhet të plotësojë Shqipëria për të arritur këtë integrim dhe pikërisht në marrëdhëniet optimale ndërkufitare. Nuk mund të integrohesh në NATO dy vende fqinjë që kanë probleme ndërmjet tyre.

Në veri dhe veriperëndim Shqipëria, konkretisht qarku i Shkodrës, kufizohet me Republikën e Serbisë dhe të Malit të Zi, konkretisht me Malin e Zi. Në këtë realitet gjeografiko-politik qarkut të Shkodrës i bie barra më e madhe në zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve tona që synojnë fillimisht të njëjtin objektiv, anëtarësimin në NATO. Historia e marrëdhënieve të Shkodrës me Malin e Zi është një histori e mbushur me ngjarje, disa herë të pakëndshme. Megjithatë historia ka bërë punën e saj, tashmë dy vendet tona demokratike janë ndërgjegjësuar se integrimi europian është prioriteti i prioritetëve, se kufijtë politikë në një të ardhme jo shumë të largët do të kthehen në kufij administrativë e kulturorë dhe se anëtarësimi në NATO është porta e hyrjes në Evropën e Bashkuar.

Në aspektin e marrëdhënieve ndërshtetërore Shkodra dhe Podgorica janë bërë tashmë qendra e takimeve ndërkufitare Shqipëri-Mali i Zi. Mund të përmendim këtu takimet e Presidentëve, Kryeministrave, Ministrave, Drejtorëve të përgjithshëm të policisë dhe atyre rajonale, drejtuesve të arkivave qendrore etj. Në aspektin e bashkëpunimit të qeverisjes lokale përmendim takimet e herë-pashershme të Kryetarëve të Bashkive të Shkodrës dhe të Podgoricës dhe të përfaqësuesve të tjerë të pushteteve lokale.

Bashkëpunimi ndërmjet policive kufitare, si një element tepër i rëndësishëm i sigurisë të dy vendeve ka patur vazhdimisht rritje në cilësi dhe sasi. Janë organizuar takime të herë-pashershme në nivel komisaratesh, drejtorive të policisë dhe ministrive përkatëse. Tematika e takimeve është përqendruar në koordinimin e veprimeve në luftë kundër trafikëve, kontrabandës dhe krimit të organizuar në dy anët e kufirit dhe më tej nëpër territoret e vendeve tona dhe atyre kufitare me ne. Arritjet në praktikë janë të dukshme. Mund të themi se tashmë siguria e

kufijve tanë shtetërorë është në një nivel të pëlqyeshëm, sidomos pas pajisjes edhe të policisë sonë kufitare me mjete të sofistikuara të siguruara nga dega e OSBE në Shkodër. Vlen të permendet instalimi i sistemit TIMS në Hanin e Hotit dhe në Muriçan, sisteme që kanë sjellë rritje cilësore në procedurat e kontrollit të shtetasve që kalojnë kufirin. Si rezultat i forcimit të këtij kontrolli dhe të bashkëpunimit të policisë doganore me policinë e shtetit është mbyllur përfundimisht kanali i trafikimit të automjeteve të vjedhura nëpërmjet kufirit të gjelbër në zonën e Vermoshit, është minimizuar pothuajse në zero fenomeni i trafikimit njerëzor dhe i prostitutave. Nuk do të ndalem më tepër në këtë problem, pasi ky përbën objektin e një teme të veçantë në këtë takim, por dua të theksoj se gjatë viteve të fundit nuk ka asnjë incident kufitar ndërmjet dy vendeve tona. Kjo është shumë e rëndësishme në aspektin e përmbushjes së detyrimeve për integrim në NATO.

Në aspektin e ekonomik dhe të lëvizjes së lirë arritjet janë të shënueshme. Qarku i Shkodrës është një nga qarqet me probleme më të mëdha ekonomike në vend. Papunësia është e një shkalle të lartë. Për këto arsye marrëdhëniet e Shkodrës me Malin e Zi janë të domosdoshme, madje jetësore. Sot në qarkun e Shkodrës ka dy pika të kalimit kufitar (Muriçan dhe Vermosh) dhe një pikë doganore (Hani i Hotit) nëpërmjet të cilës bëhet shkëmbimi i mallrave. Lëvizja e njerëzve është pothuajse e lirë, mjafton një shënim pa pagesë në pasaportë dhe mund të kalosh nga njeri vend në tjetrin. Natyrisht kjo lëvizje do të bëhej e lire sikur edhe kushti i shënimit në pasaportë të hiqej, madje dhe shkëmbimi i mallrave të behesh pa doganë, ashtu si në vendet ndërkufitare të BE-se. Ka import-eksport të mallrave të konsumit dhe të agrobiznesit. Për inkurajimin e tyre janë organizuar herëpashere panaire me prodhime të markuara. Ndërmjet dhomave të tregëtisë të dy vendeve tona ka një bashkëpunim të mirë. Është me shumë e pranishme tregtia e mallrave me pakicë. Për një lehtësim të mëtejshëm të lëvizjes së njerëzve dhe mallrave kërkohet një përmirësim i infrastrukturës rrugore nga pala malazeze matanë Muriçanit, vënia në efikasitet të plotë e hekurudhës Shkodër-Podgoricë, vënia në shfrytëzim e vijës së undrimit Virpazar-Shkodër dhe ndërtimi i superstradës Shkoder-Hani i Hotit (projekt dhe grant i Qeverisë Italiane). Në energjitikë e rëndësishme do të jetë linja e interkonjeksionit Elbasan-Podgorice. Fillimi i funksionimit të bankave dhe i agjensive të përbashkëta do të ishte një hap tjetër drejt forcimit të bashkëpunimit dypalësh.

Probleme etnike ndërmjet dy vendeve tona mund të themi se nuk ka. Brezi kufitar i Qarkut të Shkodrës me Malin e Zi është i banuar nga një shumicë shqiptare. Ajo është ura lidhëse më e mire ndërmjet dy shteteve tona. Në Malin e Zi shqiptarët po gjejnë gjithnjë edhe më tepër hapësire në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të tij. Mjafton të përmendim se ministri i pakicave është shqiptar. Krahas shkollave në gjuhën shqipe në rajonet me shumicë shqiptare tashmë edhe në Universitetin e Podgoricës është hapur dega e gjuhës shqipe, ku japin mësim pedagogë nga Universiteti i Shkodrës. Ndërmjet këtij të fundit dhe Universitetit të Podgoricës ka marrëveshje bashkëpunimi. Shkëmbimet uni-

versitare kanë ardhur gjithnjë në rritje në sasi dhe cilësi. Ka gjithnjë e më tepër punime shkencore me autorë të përbashkët.

Në Shqipëri, pakicat serbo-malazese kanë qenë të përqendruara në fshatin Vrakë e përreth. Një pjesë e tyre u zhvendosën në ish-Jugosllavi, të tjerë në Shkodër e nëpër Shqipëri, ndërsa pjesa e mbetur jeton në harmoni me banorët e rinj të ardhur aty nga zonat e thella të qarkut tonë. Në Vrakë është ndërtuar një kishë e bukur ortodokse. Pakica serbo-malazeze merr pjesë në jetën politike, lokale dhe kombëtare e përfaqësuar nga PBDNJ. Gjithashtu në Shkodër ka mjaft banorë me origjinë nga Ulqini e qytete të tjera të Malit të Zi, të cilët i kanë të afëmit e tyre përtej kufirit shtetëror. Shoqata Moraça-Rozafa e krijuar që në ditët e para të pluralizmit është kujdesur për rivendosjen e marrëdhënieve të humbura gjatë viteve. Një bashkëpunim intensiv ka ndërmjet komunës së Ulqinit dhe Bashkisë së Shkodrës sidomos në fushën e arsimit, kulturës dhe turizmit. Një numër i madh sesionesh shkencore-kulturore të përbashkëta janë zhvilluar gjatë viteve. Në panairët e librave në Ulqin marrin pjesë gjithnjë e më tepër botues shqiptarë. Fototeka “Marubi” është një pasqyrë e marrëdhënieve të hershme të Shkodrës me Malin e Zi. Plazhet e Ulqinit dhe të vendeve të tjera përreth frekuentohen çdo vit nga qindra turistë shqiptarë.

Një element shumë i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkufitar është Liqeni i Shkodrës, që kohët e fundit ka filluar të quhet liqeni i Miqësisë. Me kohë ai është shpallur “Park kombëtar” nga Mali i Zi dhe kohët e fundit ky liqen ne anën tone ka fituar statusin e “zonës së mbrojtur”. Është ky liqen që ka bërë të mundur futjen në Europë të dy vendeve tona me projekte të përbashkëta siç është projekti i qendrës rajonale të mjedisit REC, projekti i Bankës Botërore dhe kohët e fundit mendohet të zbatohet projekti i Këshillit të Europës për trashëgiminë kulturore.

Është për t'u përshëndetur puna intensive e realizuar nga stafi EPTISA i financuar nga Komisioni Europian për projektin “Podshkodra”, projekt i cili kërkon ta kthejë rajonin Lezhë-Shkodër-Podgoricë në një rajon të zhvilluar ekonomik, kulturor dhe turistik. Ai do të diskutohet në komunitet dhe në institucionet lokale dhe shtetërore për t'i bërë opionencën shkencore. Fillimisht aty propozohen 10 propozime të menjëhershme veprimi me një vlerë prej 60 milionë euro. Pas miratimit në parim është rradha e gjetjes së donatorëve dhe investitorëve strategjikë. Shkodra mund dhe duhet të jetë qendra e koordinimit të këtij projekti ambicioz. Nga realizimi i plotë i tij Shkodrës do t'i rikthehej tradita e shkëlqyer ekonomike, kulturore dhe turistike. Kjo do të ishte një hap shumë i rëndësishëm, madje edhe përfundimtar për plotësimin e kushteve të sigurisë kufitare në kufirin shqiptaro-malazez.

Institucioni i prefektit në Shkodër ndjek me kujdes dhe inkurajon zhvillimet ndërkufitare në shërbim të realizimit të programit të Qeverisë sonë drejt integritimit sa më të shpejtë të Shqipërisë në NATO dhe BE.

Duke përmbledhur do të thoja se disa masa drejt forcimit të sigurisë rajonale Shqipëri - Mali i Zi do te ishin:

1. Heqja e plotë e sistemit të shënimeve në pasaportë në pikat kufitare respektive dhe heqja e vizave ndërmjet Shqipërisë, Bosnje- Hercegovinës dhe Kroacisë.
2. Zvogëlimi në minimum i shkëmbimit të mallrave me doganë.
3. Patrullim i përbashkët i rojeve kufitare në luftë kundër kontrabandës dhe trafikimit. Trajnimi i përbashkët i tyre me ndihmën e strukturave përkatëse europiane.
4. Kthimi i Liqenit të Shkodrës i tëri në park kombëtar dhe krijimi i strukturës së përbashkët të rengjersave në mbrojtje të mjedisit.
5. Fillimi i funksionimit të rrugës liqenore Virpazar-Shkodër.
6. Ristrukturimi i rrugës Ulqin-Muriçan dhe ndërtimi i superstradës Shkodër-Han i Hotit.
7. Përdorimi i transportit hekurudhor edhe për transportimin e pasagjerëve.
8. Krijimi i bankave dhe agjensive turistike të përbashkëta. Hartimi i një guide turistike "Podshkodra" e cila të përfshinte bregdetin Shëngjin-Ulqin-Tivar dhe zonat malore kufitare të dy vendeve.
9. Krijimi i ndërmarrjeve shqiptaro-malazeze me kapital të përbashkët sidomos në industrinë e peshkut dhe industrinë e lehtë.
10. Realizimi i projektit "Podshkodra" me përmirësimet e bëra.
11. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Shkodrës dhe atij të Podgoricës.
12. Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 KV Elbasan-Podgoricë.

“BASHKEPUNIMI MIDIS POLICISE KUFITARE NE DIBER DHE KOLEGEVE TE TYRE MAQEDONAS”

Xhafer Seiti
Prefekti i Qarkut të Dibrës

Duke e konsideruar nder të veçantë pjesëmarrjen në këtë Konferencë, më lejoni të shtroj para këtij auditori të respektuar disa mendime modeste rreth tematikës që diskutohet dhe një pjesë të problematikës në qarkun e Dibrës.

Qarku i Dibrës shtrihet në zonën verilindore të Shqipërisë në një sipërfaqe prej 2507 kilometër katror, duke zënë vendin e gjashtë ndër 12 qarqet e Republikës përse i përket shtrirjes gjeografike, ka tre rrethe: Dibër, Bulqizë e Mat, brenda të cilëve janë 31 komuna që përfshijnë 279 fshatra dhe katër bashki. Qarku i Dibrës kufizohet me Kukësin, Mirditën, Kurbinin, Librazhdin, Tiranën dhe me 91 kilometër kufi shtetëror me ish - Republikën Jugosllave të Maqedonisë, nga të cilat 15 km me lumë, 9 km me përrenj dhe 67 km kufi tokësor. I veçantë në kufirin shtetëror në rajonin e Dibrës është fakti se ndryshe me shume vende të tjera, në të dy anët e tij ka një komunitet të madh banues me lidhje gjaku, fafesisnie, miqësie, dikur të harruar dhe sot edhe biznesi. Janë banorë të një kombi, të cilët formalisht i ndan një vijë kufiri, me shumë rrugë që shkojnë paralel ose tërthorazi me të.

Nënshkrimi i katër Marrëveshjeve Ndërqeveritare nëpërmjet Ministrive të Punëve të Jashtme të qeverisë shqiptare dhe asaj të ish - Republikës Jugosllave të Maqedonisë me 4 dhjetor 1997, ratifikuar nga parlamenti më 14.01.1998 dhe e pesta, ajo e Ripranimit e vitit 2005; pjesëmarrja e kuadrove të policisë që punojnë me kufirin në qarkun e Dibrës në veprimtari trainuese në Bosnje, Shkup, Tiranë, Athinë; organizimi i kurseve 10 - ditore të trainimit deri në pesë herë në vit për marrjen e njohurive lidhur me menaxhimin e integruar të kufijve për sigurimin e lëvizjes së lirë sipas ligjit, të njerëzve e mallrave dhe zbulimin, pengimin e goditjen e trafikëve të paligjshme; ndihma e dhënë nga vendet mike, anetarë të BE, veçanërisht mjaft projekte të ndërmara nga DANIDA dhe Tresta nën kujdesin e qeverisë daneze, në zbatim të nenit 3 të Marrëveshjes midis qeverisë shqiptare dhe qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës bërë më 02 qershor 1999 në Kopenhagen; kanë dhënë rezultatet e tyre pozitive në shumë drejtime e veçanërisht në ato drejtime që kërkohen për anëtarësim të Shqipërisë në NATO.

Projekti për binjakëzim për policinë, që pati në esencë strategjinë e kontrollit

të kufirit dhe menaxhimit të integruar të tij, inicuar nga DANIDA, menaxhuar e drejtuar nga oficerë të talentuar danezë, dha rezultate konkrete në këtë drejtim. Projekti arriti deri në hartimin e një Memorandumi Mirëkuptimi, i cili, ndonëse i mirëpërgatitur, nuk u arrit të firmosej.

Për forcimin e kontrollit të kufirit vetë strukturat e policisë evropiane kanë trainuar punonjësit e policisë së qarkut Dibër dhe kanë bërë furnizime me kamera termike e mjete optike të domosdoshme për perfeksionimin e punës në kufi. Mbi 70% e punonjësve të kufirit janë trainuar dhe njohur me parametrat që kërkon Evropa për Ballkanin Perëndimor, duke qenë efikas njëkohësisht në punën për sigurinë e kufijve.

Mendimi i specialistëve të policisë, konsoliduar nga rezultatet e arritura, ka një emërues të përbashkët, atë të dakordësisë për hapa shumë pozitivë, veçanërisht nga viti 2003 e në vazhdim si rezultat i punës së policisë në përgjithësi e asaj kufitare në veçanti, vetë komunitetit që banon në zona ndërkufitare, duke arritur që për këtë periudhë të mos ketë asnjë vrasje apo plagosje në gjithë vijën kufitare, gjëra që kanë qenë “në modë” në të kaluarën jo të largët. Ndonëse komisionet dypalëshe për zgjidhjen e incidenteve në kufi kanë funksionuar normalishtë, në këto vitet e fundit nuk kanë pasur lëndë për diskutim të emërtuar incident.

Që nga muaji mars 2003, me ndërmjetësinë e policisë daneze u muar nisma për të marrë përsipër e zbatuar një projekt për forcimin e kontrollit të kufirit, gjë e cila vazhdon dhe sot. Ky projekt konsiston në shtimin e kontakteve të përbashkëta duke u shtrirë në tre nivele:

1. Lokal - ndërmjet dy komandatëve, të Bllatës me homologët e palës tjetër.
2. Rajonal - ndërmjet shefit të Policisë së Dibrës dhe Komandantit të kufirit të Shqipërisë me ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë.
3. Qendror - me përfaqësuesit e dy qeverive në nivel drejtorësh të Drejtorisë së Kufirit Shqiptar dhe Brigadës së Kufirit nga pala tjetër.

Në bazë të këtij projekti janë zhvilluar takime të përbashkëta për probleme të sigurisë në kufi, janë shkëmbyer informacione për shqetësimet, trainime të policisë së dy shteteve në mjedise të përbashkëta, vizita praktike në postat analoge, dhënie leksionesh nga specialistë të ndërsjelltë, gjë që ka rritur cilësisht frymën e bashkëpunimit duke bërë që elementi i keq edhe në zonat e largëta ta ndiejë këtë frymë bashkëpunimi, të ndihet nën presion e të rrudhet.

Duke konsideruar informacionin si parësor në ruajtjen e kufirit, krahas punës së katër inspektorëve të informimit në Dibër e Bulqizë, efikas ka qenë dhe thithja e informacionit nga pala matane kufirit dhe veprimi i strukturave tona mbi bazën e këtij informacioni e anasjelltas.

Që nga muaji prill 2005 policia kufitare ka të normuar organizimin e takimeve të përbashkëta me ndërrim territori të komandatëve të pikave të kalimit dhe komandatëve të grupeve operacionale Bulqizë e Dibër me homologët, takime

këto që zhvillohen veçmas, ku shkëmbehen informacionet dhe shqetësimet dhe krijohet baza e problematikës për takimet rajonale një herë në tre muaj. Përsosmërisë së bashkëpunimit i ka shërbyer dhe fakti që nga prilli 2005 edhe shteti fqinj , kufirin e ruan me polici.

Ndër arritjet mund të shënohet fakti që policitë kufitare të dy vendeve në bashkëpunim kanë goditur kontrabandën në kufi, kryesisht të vicave hormonalë, medikamenteve farmaceutike, cigareve kontrabande nga Shqipëria, kalimeve të paligjshme të shtetasve, duke synuar që të goditet trafiku pa menduar se kush do t'i marre meritat. Për ta bërë informacionin më të shpejtë dhe rezultativ, drejtuesit respektive në dy anët e kufirit kanë shkëmbyer numrat e telefonave, gjë që ka shpejtuar informacionet, ka tkurrur elementin kontrabandist, siguria në kufi është bërë e qëndrueshme, por dhe janë rënduar ekonomikisht drejtuesit e policisë kufitare shqiptare, pasi për ta nuk ka asnjë lloj rimbursimi për telefoninë, kur dihet që në telefoninë celulare aplikohen tarifat me jashtë shtetit që kanë kosto të lartë.

Finalizimi i bashkëpunimit mes dy policive kufitare është organizimi i patrullave të përbashkëta. Deri në këto momente është arritur që policitë të ndajnë sektorët, në mënyrë figurative policitë i janë larguar atij shërbimi në të cilin forcat i rrinin përballë njëra - tjetrës. Nga policia kufitare gjate muajve turistikë të verës është bërë natyrë pune që të angazhohen më shumë forca brenda organikës dhe strukturës në pikat e kalimit kufitar dhe fluksi i kalimeve ka ardhur në rritje. Kështu për vitin 2005 ky fluks u rrit me 17% krahasuar me vitin 2004 duke shkuar në shifrat e hyrjeve shqiptare në 36493 shtetas dhe 6528 mjete, daljeve shqiptare në 48180 shtetas e 6930 mjete, hyrjeve të huajve 19721 shtetas dhe 2015 mjete e daljeve të huajve në 18493 shtetas dhe 1924 mjete. Natyrisht që për të arritur aty ku duhet ka akoma dhe probleme, ndër të cilat do të veçonim:

- Nisur nga fakti që organet e qeverisjes vendore dhe ato të rendit varen në të njëjtën ministri gjykojmë se nuk çënohet autonomia e organeve të qeverisjes vendore nëse do të ketë një udhëzues detyrues për bashkëpunim mes tyre dhe policisë kufitare.

- Organikat e kufirit, në syrin e specialistëve të mirëfilltë, konsiderohen të pakta në numër, më pak se një polic për një kilometer kufi dhe, nga ana tjetër , krahas specialistëve të përkushtuar, që tanimë nuk mungojnë në kufi, duhet të hiqet dorë një herë e mirë nga koncepti i trashëguar i dërgimit në kufi të kuadrove më të dobët, kufiri të mos jetë as “magazinë e të paaftëve”, as vendi ku “mund të hiqen qafet të dobëtit”. Vendi i kuadrit të aftë, në kushtet dhe me kërkesat e sotme, duhet të jetë në kufi, natyrisht me një pagesë të diferencuar e kushte më të mira jetese për vete e familjen, pasi është polic pa vendroje, të sigurohet transporti i garantuar jo vetëm për policinë e kufirit, por dhe për llojet e tjera të policisë. Ndërsa një mësues apo grup mësuesish nuk shkojnë në vendin e punës, qoftë dhe 1-2 km larg, po qe se nuk kanë mjet lëvizës, duke lënë

nxënësit pa mësim, policët janë të detyruar të lëvizin më këmbë ditën e natën, në kohë të nxehtë e në acar. Dhe në vazhdim të kësaj ideje mendojmë që kuadri duhet të jetë stabël, specialisti i kufirit duhet t'i mbetet kufirit, lëvizjet të mos jenë të shpeshta, të ketë një uniformë shërbimi për policinë kufitare veç asaj të zakonshmes.

- Vend për të punuar më shumë ka në ndërtimin e bashkëpunimit polici - komunitet dhe përsosjen e etikës së policisë për të cilat duhet një bashkëpunim më i mirë mes organeve të qeverisjes vendore dhe strukturave drejtuese në polici.

- Probleme ka dhe për infrastrukturën. Dogana e Bllatës nuk plotëson asnjë lloj kushti përse i përket mjedisëve, ajo mund të konsiderohet jashtë funksioni e jo më të krahasohet me parametrat evropiane, ndonëse për të nga IOM-i janë dhënë rreth 20 mijë dollarë. Pika e kalimit ka një dhomë e një aneks, nuk ka dhomë shoqërimi, akoma pika e kalimit është me trarë, kur kufitarët matanë e kanë moderne, nuk ka rrethim të rrugëkalimeve, mungon energjia elektrike e vazhdueshme, problemi është zgjidhur pjesërisht me dy gjeneratorë të dhuruar nga DANIDA, kushtet për jetesë të grupeve operationale dhe të efektivit janë të vështira, nuk ka një valë radioje për komunikim etj.

- Po kështu specialistët mendojnë se disa objekte në kufi janë të pastudiuara, aty ku ka qenë dhe duhet postë si në Kala të Dodës në Dibër, mezi është bërë e mundur një minigos (postë e vogël), në posta nuk ka ndriçim, nuk ka kushte.

- Një problem të cilin ne e quajme efikas është dhe nevoja e heqjes së taksës së kufirit prej 10 euro. Shqiptarët nuk kanë dëshirë të kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme, por i detyron nevoja ekonomike. Ata bëhen "shkelës", qoftë dhe për të shkuar në një dasëm, apo rast fatkeqesie. Kartoni ka vlerë dy herë në muaj nga 24 orë dhe nuk e zgjidh problemin.

- Hapja e një pike të re kalimi në Vërnice do të lehtësonte problemet dhe do të eliminonte kalimet e paligjshme. Banori i zonës së Gollobordës nuk do të ishte i detyruar të bënte dhjetra kilometra rruge për të ardhur në Bllatë e për të kaluar kufirin. Kjo pikë le të jetë dhe e kategorisë së tretë, por vetëm të hapet.

- Kohët e fundit është firmosur marrëveshja e ripranimit në nivel drejtorësh të policisë qendrore të dy shteteve, ndërsa firmosja e një Memorandumi Mirëkuptimi nga Ministrat përkatës do të lehtësonte shumë procedura. Ndërsa ushtria e ka një të tillë, gjykojmë se nuk ka pse mos ta ketë dhe policia.

Duke përfunduar, më lejoni të shpreh gatishmërinë time si prefekt i qarkut Dibër, përfaqësues i qeverisë shqiptare në atë rajon, për të qenë në çdo kohë ndër të tjera dhe në funksion të zbatimit të detyrave progresiste që do të dalin nga kjo konferencë.

“REFORMAT E SIGURISE KUFITARE”

Bajram Ibraj

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Policia e Shtetit e ka trajtuar e zbatuar Reformën e Sigurisë në Kufi si aspekt shumë të rëndësishëm të sigurisë kombëtare, por edhe si një detyrim partnershipi për antarësim në strukturat euroatlantike dhe për asociimin në BE, për ndërtimin e besimit me shtetet fqinje dhe më gjerë, si dhe për të kontribuar në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit ndërkombëtar.

Kjo reformë është institucionalizuar tashmë nëpërmjet një dokumenti strategjik “Për Kontrollin e Kufirit dhe Menaxhimin e Integruar të tij”, i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 118, datë 27.02.2003 dhe i orientuar nga zbatimi dhe implementimi i udhëzimeve të BE për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, ku në themel të tyre qëndron parimi: “kufij te hapur, por të sigurt”.

Qellimi strategjik i këtij dokumenti është: “Krijimi i nje modeli te integruar te sigurise ne kufi qe t’i perqaset standarteve te Marreveshjes se Shengenit, si nje aspekt shume i rendesishem i sigurise kombetare, per te garantuar levizjen e lire e te ligjshme te shtetasve dhe per te parandaluar imigrimin e paligjshem”.

Nëpërmjet kësaj reforme synohet të arrihen këto objektiva:

- Organizimi i survejimit të kufirit mbi një sistem sinjalizimi dhe aftësie reaguese.
- Krijimi i lehtësirave në portat e hyrjes dhe daljes nga Republika e Shqipërisë, si dhe vendosja e mjeteve të nevojshme për kontrollin e domosdoshëm të personave dhe dokumentave të udhëtimit.
- Forcimi i kontrollit ndaj shtetasve të huaj që mund ta përdorin vendin tonë si vend tranzit, në kufi dhe thellësi të territorit.
- Forcimi i bashkëpunimit midis operatorëve të ndryshëm kombëtarë e ndërkombëtarë, në interes të forcimit të sigurisë.
- Krijimi i partneritetit dhe besueshmërisë me shtetet fqinje e më gjerë në luftën ndaj krimit ndërkufitar.

Arritja e synimeve të kësaj strategjie është gërshetuar edhe me implementimin e rekomandimeve të rrjedhura nga dokumenta të tjerë të rëndësishëm në fushën e sigurisë në kufi, siç janë:

- Dokumenti Final i Konferencës së Ohrit “Mbi menaxhimin dhe sigurinë në kufi”;
- Udhëzuesi i BE-së “Për Menaxhimin e Integruar të Kufijve në Ballkanin Perëndimor”;
- Programi i antarësimit në NATO;
- Dokumenti i Partneritetit European;
- Dokumenti për përafrimin e legjislacionit me BE-në, etj.

Synimi i parë dhe më i rëndësishëm i strategjisë ishte kuptimi dhe familjarizimi me parimet e standartet e BE-së për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, që nënkupton jo më mbrojtje ushtarake lineare në gjithë gjatësinë e tyre me format tradicionale të patrullimit apo pikave të vrojtimit, por monitorimin e kufirit tokësor, detar e ajror me pikësynim parandalimin dhe zbulimin e çdo tentative apo përpjekje për shfrytëzimin e tij si rrugëkalim nga krimi ndërkufitar, veçanërisht nga ai i organizuar nëpërmjet trafikëve të paligjshme dhe organizatat terroriste.

Sigurisht që ky hap i parë mund të them se ishte më i vështiri, pasi kishte të bënte me thyerje të mentaliteteve e traditave të rrënjosura ndër vite, të bazuara në konceptet izolacioniste të së kaluarës totalitariste, të veshura me mantelin e nacionalizmit, se modeli i ri i ruajtjes së kufirit mund të dobësonte elementet e mbrojtjes së pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit.

Prania e specialistëve të misioneve policore ndërkombëtare si PAMECA, ICITAP e INTERFORCA me këshillimet dhe ekspertizën e tyre, trainimet dhe vizitat studimore brenda e jashtë shtetit, njohja me eksperiencat e vendeve të BE-së si dhe instrumentave juridik e institucional të KE-së ishin faktor bindës dhe reformues, jo vetëm në mjedisin policor, por dhe atë vendimarrës politik.

Kuptimi dhe adaptimi me konceptet e reja të menaxhimit të integruar të kufirit, krijoi terrenin e përshtatshëm për hapat e mëtejshëm të reformës, si ato në planin legjislativ, organizativ dhe të infrastrukturës logjistike.

Mbi këtë vizion të ri për sigurinë në kufi, u punua për hartimin dhe miratimin e bazës së nevojshme legjislative si dhe akteve të tjera nënligjore në funksion të zbatimit të saj. Ndër aktet ligjore më të rëndësishme mund të përmend:

- Ligji për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji për ruajtjen e kontrollin e kufirit shtetëror të RSH;
- Ligji për të huajt;
- Ligji për azilin në RSH;
- Ligji për shtetësinë;
- Ligji për regjistrimin, klasifikimin, mënyren e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me tonazh nën 20 NT.

Ndërkohë janë në proces hartimi apo miratimi ndryshime të tjera të nevojshme legjislative, të cilat do të plotësojnë në mënyrë më komplementare paketën ligjore e normative në këtë sektor të sigurisë. Kështu mund të përmend:

1. Përgatitjen e Projektligjit “Për Policinë Kufitare dhe Migracionit”, i cili do të kalojë në procedurë miratimi menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”.
2. Eshtë ngritur grupi i përbashkët i punës dhe po punohet për përgatitjen e ligjit të ri për të huajt.
3. Ka dalë Urdhri i Kryeministrit për ngritjen e grupit ndërministror për amendimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Kufijve.
4. Eshtë përgatitur dhe pritet të miratohet së shpejti modeli i vizës pullë, me elemente të lartë sigurie dhe që do të lehtësojë formalitetet e procedurat për pajisjen e shtetasve të huaj që dëshirojnë të hyjnë në Republikën e Shqipërisë. Kjo përbën edhe plotësimin e njërit nga detyrimet e rekomandimeve të BE-së për përafrimin e standarteve.

Vlen të theksohet se në legjislacionin e ri, shërbimet e ruajtjes së kufirit janë konceptuar si shërbime policore me atributet e nevojshme për të realizuar jo vetëm ruajtjen fizike të tij, por edhe luftën parandaluese e zbuluese ndaj krimit si dhe mbajtjen e rendit publik në zonat kufitare. Për herë të parë këtyre shërbimeve iu dhanë atributet e policisë gjyqësore si subjekte të procedimit penal për krimet e konstatuara në apo nëpërmjet kufirit.

Ndryshimet e mësipërme ligjore nuk do të ishin të zbatueshme po të mos ishin shoqëruar me riorganizimin strukturor dhe ngritjen e nivelit profesional të punonjesve të policisë në shërbimet e kontrollit të kufirit, në përshtatje me parimet e menaxhimit të integruar të tij. Kështu një procesi reformues rrënjësor iu nënshtrua drejtoria e Policisë Kufitare në qendër si edhe gjithë strukturat vartëse të saj në nivel drejtorie qarku e komisariate, ku brenda këtyre strukturave për herë të parë u përfshinë edhe shërbimet e migracionit dhe për shtetasit e huaj me qëndrim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë. Krijimi i Grupeve Operacionale Speciale brenda shërbimeve të kontrollit të kufirit ishte gjithashtu një mënyrë operimi në përputhje me konceptet e menaxhimit të integruar të tij. Këto grupe të pajisura tashmë me infrastrukturën e nevojshme logjistike lejojnë fleksibilitet e manovrueshmëri më të madhe taktike të këtyre shërbimeve në funksion të kontrollit në drejtimet më të mundshme prej nga mund të penetrojnë grupet kriminale apo të realizohen trafiket ilegale. Me forca dhe mjete që ato disponojnë synohet të mbahet nën kontroll kufiri shtetëror, duke i planizuar shërbimet jo në proporcion të drejtë në të gjithë kufirin shtetëror, por në drejtimet më problematike sipas fluksit të levizjes të lirë të njerezve, mjeteve e mallrave, parandalimit të migracionit të paligjshëm, trajtimit të rasteve të azilkërkuesve, refugjatëve dhe emigrantëve ekonomikë, pozicionit gjeografik dhe marrëdhënieve me shtetet fqinje.

Këto ndryshime strukturore u kryen paralel me trainimin e punonjesve të policisë kufitare, në mënyrë që niveli i tyre profesional të ishte në akordancë me legjislacionin e ri dhe praktikatat e reja. Falë ndihmës dhe mbështetjes bujare

të misionëve PAMECA, ICITAP, INTERFORCA, projektit danez DANIDA si dhe shumë organizmave ndërkombëtarë si IOM, UNHCR, PNUD etj. ne tashme kemi një personel tërësisht të trainuar dhe të azhornuar me standartet e BE-së. Ndërkohë që mësimi i gjuhës angleze dhe përvetësimi i kompjuterit janë përfshirë në kriteret e punësimit në këto struktura.

Ndër masat më të rëndësishme për reformimin strukturor e profesional të Policisë Kufitare mund të përmend:

1. Ristrukturimi i Policisë Kufitare dhe Migracionit, në kuadër të strukturës së re të Policisë së Shtetit me më shumë autonomi nga qendra në baze dhe decentralizim të përgjegjësive e kompetencave operacionale në nivel qarku e komisarati.
2. Heqja e shërbimit të detyrueshem ushtarak në Policine Kufitare dhe plotësimi organik me punonjës policie profesionist.
3. Trainimi i punonjësve të policisë së këtij shërbimi të të gjitha roleve e niveleve, brenda e jashtë shtetit.
4. Trajnimet për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit.
5. Trajnimet për mësimin e gjuhës angleze duke filluar me kurset pilot në Tiranë, Shkodër dhe Kukës.
6. Trajnimet e nivelit strategjik nga DCAF (Qendra për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura).

Sigurisht që gjithë këto ndryshime legislative, organizative dhe strukturore nuk mund të ishin eficente pa një mbështetje logjistike bashkëkohore, sidomos në fushën e teknologjisë së informacionit, e cila jo vetëm rrit efektivitetin e punës, por është mbi të gjitha edhe një element vetkontrolli në luftën ndaj korrupsionit në radhët e efektivave të policisë kufitare. Në kushtet kur lëvizja e lirë e shtetasve dhe mallrave nëpërmjet kufirit është rritur në progresin gjeometrik me të kaluarën, përballimi i fluksit në rritje të shkëmbime ndërkufitare ishte gati i pamundur nëpërmjet veprimeve manuale dhe procedurave tradicionale të kontrollit. Fale ndihmës financiare të Programit CARDS të BE-së dhe investimeve nga buxheti i shtetit ne kemi mundur të rinovojmë gjithë bazën logjistike në pikat e kontrollkalimit, duke futur në përdorim mjete e pajisje të sofistikuara për kontrollin e dokumentave dhe mallrave që qarkullojnë nëpërmjet kufirit, por që kanë lehtësuar e përshpejtuar edhe procedurat e kalimit të kufirit. Kjo është dëshmuar sidomos në periudhat e pikut të fluksit të emigrantëve që kanë ardhur në vend gjatë sezonit të pushimeve verore apo në rastet e festave të fundvitit.

Futja e teknologjisë së informacionit në përdorim në sistem të gjerë në të gjitha pikat e kontroll kalimit ka rritur në mënyrë të ndjeshme rezultatet e policisë kufitare në parandalimin dhe goditjen e veprimeve kriminale nëpërmjet kufirit, si dhe emigrimit të paligjshëm. Kjo dëshmohet sidomos në statistikat e luftes kundër trafikut të qenieve njerëzore, që kanë ardhur në ulje nga vit në vit, si dhe në rastet e goditjes së trafikut të drogës, ku rastet e kapura nga kontrolli kufitar

kanë qenë shumfish më të larta se në vitet e kaluara. Por efektivitetin më të lartë kjo teknologji bashkëkohore e ka treguar në rastet e identifikimit dhe kapjes së personave në kerkim, si dhe ndaj grupeve kriminale që merren me falsifikimin e dokumentave të udhëtimit për jashtë shtetit. Parandalimi i trafikut të qenieve njerëzore dhe migrimit të paligjshëm nëpërmjet sistemit të teknologjisë së informacionit ka ndikuar edhe në parandalimin e penetrimit në vend të personave të dyshimtë për pjesëmarrje në organizata terroriste ndërkombëtare, që në të kaluarën e kanë shfrytëzuar vendin tonë si vendbazim apo tranzit për në vendet euroatlantike.

Disa nga arritjet në këtë drejtim janë:

1. Informatizimi edhe i 5 PKK të reja dhe përfundimi i instalimit të rrjetit TIMS, duke përfunduar kështu informatizimin e të gjitha PKK kryesore dhe lidhjen e tyre në rrjet si në Rinas, Durrës, Vlore, Kakavijë, Kapshticë, Qafë Thanë, Tushemisht, Murriqan, Hani i Hotit, Morinë.
2. Po përgatitet projekti për informatizimin e PKK-ve të kategorise së II.
3. Kompletimi me pajisje për zbulimin e dokumentave fallco dhe minilaboratorëve i PKK kryesore me financime nga programi CARDS. Pajisja e 20 PKK me aparatura të zbulimit të dokumentave fallco, 50 lexues pasaportash, printer për gjurmet e gishtave, 5 kompjutera laptop, 25 celularë fiks GSM, 25 aparate telefonik dhe fotokopjues, fax-e, skaner dhe 25 printera të lëvizshëm.
4. Fuqizimi i rrjetit të radiokomunikacionit.
5. Instalimi dhe futja në on-line e një rrjeti modern komunikimi me radio dhe pajisje të tjera plotësuese për Policinë Kufitare dhe Migracionit, dhuratë e OSBE në vlerë 220.000 Euro, i përbërë nga 17 repetitorë (14 fikse dhe 3 të lëvizshëm), 72 radio dore dhe 15 stacionerë.
6. Kompletimi i patrullave kufitare për herë të parë me mjete të vëzhgimit optik si:
 - a. Dylbi nate 28 copë.
 - b. Kamera termike 11 copë.
 - c. Dylbi të zakonshme 100 copë.
 - d. Elektrik dore të karikueshëm 100 copë.
7. Eshtë në proces kompletimi i PKK me ndriçues të fiksuar, pajisje dedektore për drogat, pajisje për kontrollin e makinave dhe bagazheve për drogë, ADM etj.
8. Me financim të Delegacionit të BE-së, janë në proces montimi ura ngjitëse për kontrollin e automjeteve në 5 PKK, etj.
9. Me financime të projektit CARDS u blenë dhe iu dhuruan ditët e fundit 50 autovetura me kalueshmëri të lartë, 12 mikrobuze, 20 motocikleta dhe një sasi e konsiderueshme pajisjesh e mjeteve dedektuese për Policinë Kufitare.

Të gjitha këto investime kanë ndikuar e do të ndikojnë në përmirësimin e shërbimit të kontrollit të kufirit në lehtësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve e mallrave nëpërmjet kufirit, por nga ana tjetër do të bëjnë më të sigurtë regjimin e hyrje/daljeve në Republikën e Shqipërisë.

Element tjetër i rëndësishëm në reformën e sigurisë në kufi është edhe partneriteti ndërkuftar me shtetet fqinje e me gjerë në rajon. Krijimi i besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimi dypalësh e shumëpalësh në vijën kuftare apo për çështje të sigurisë kuftare është një faktor i rëndësishëm në kuadër të sigurisë kolektive që duhet të prodhojnë të gjitha vendet që janë kandidatë apo aspironjë të hyjnë në BE, sikundër është vendi ynë, aq më tepër kur ne konsiderohemi si kufiri i jashtëm i këtij komuniteti.

Duke nënshkruar një sërë marrëveshje ripranimi me vendet e BE-së dhe duke rinovuar e lidhur marrëveshje të reja me vendet e fqinje e të rajonit, si për bashkëpunimin ndërkuftar, ashtu dhe në fushën e luftës kundër krimit të organizuar e luftës ndaj terrorizmit, vendi ynë ka shprehur njeherazi vullnet politik e institucional për të qenë partner i besueshem në koalicionin e shteteve demokratike kundër botës së krimit. Tashmë ne kemi dalur nga pozicioni pritës, duke ndërmarrë shpeshherë iniciativën promovuese të këtyre marrëveshjeve si në rastet e protokollit të bashkëpunimit me UNMIK, palën malazeze, maqedonase etj. Ndërsa kemi qenë organizatorë dhe pritës të disa tryezave ndërkombëtare rajonale për bashkërendimin e masave të luftës kundër krimit të organizuar e terrorizmit. Këto marrëveshje e takime institucionale tashmë janë konkretizuar me aksione të përbashkëta operacionale, që kane çuar në goditjen e rrjeteve të rrezikshme të trafikut ndërkombëtar të drogave të forta, armëve dhe qenieve njerëzore. Kapja e sasive të konsiderueshme të heroinës dhe e eksplozivëve të pajisur me komandues në distancë (celularë) kanë qenë disa nga rezultatet më premtuese të bashkëpunimit shumë të mirë policor që kemi arritur të vendosim me shtetet fqinje, sidomos Malin e Zi dhe Maqedoninë.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, më duhet të përmend si element të domosdoshëm në çështjet e sigurisë bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe mediat. Duke institucionalizuar këto marrëdhënie ne kemi mundur të krijojmë një front unik me sfond realizimin e standarteve në respektimin e lirive e të drejtave universale, por edhe të bashkërendojmë veprimet për të krijuar një ambient sa më të sigurt për qytetarët e ndershëm. Zhvillimi i aktiviteteve sensibilizuese për të ftuar komunitetin në të qenin aktiv ndaj çështjeve të sigurisë publike, ka bërë që të rritet partneriteti Polici-Komunitet. Një nga partneret tanë më luajal në këtë drejtim ka qenë Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, i cili është nismëtar i shumë projekteve tona për implementimin e filozofisë së Policimit në Komunitet. Grupet konsultative polici-komunitet apo iniciativat llogaridhënëse janë tashmë një realitet dhe janë mirëpritur e mbështetur nga publiku. Këto aktivitete janë dëshmi e produktivitetit të këtij partneriteti, të cilin duhet ta thellojmë dhe institucionalizojmë akoma më shumë.

Prania e medias në këto aktivitete ka bërë të mundur amplifikimin e tyre, duke sensibilizuar gjithnjë e më shumë një masë më të madhe të komunitetit se çështjet e sigurisë publike nuk janë detyrë vetëm e organeve shtetërore, por e gjithë shoqërisë.

Në përfundim të kësaj kumtese, si konkluzion i gjithë retorikës time të mësipërme, por dhe vlera e kësaj konference, mund të përmbliidhen më pak fjalë, se sa më të bashkuar e aktivë të jenë të gjithë aktorët e faktorët social-politik në çështjet e sigurisë së rendit publik, aq më shumë do të mundemi t'i gëzojmë produktet e demokracisë, aq më mirë do të mund t'i gëzojmë liritë e të drejtat universale.

“HAPAT DREJT SIGURISE KUFITARE TE SHQIPERISE SIPAS STANDARTEVE EUROPIANE”

Joachim Tasso Vilallonga

Kordinator i Çështjeve të Brendshme

dhe të Drejtësisë Delegacioni i Komisionit të Bashkimit Evropian

Së pari dëshiroj të falendëroj organizatorët, dhe në veçanti IDN, për ftesën e bërë Komisionit Evropian për të marrë pjesë në këtë konferencë. Është me të vërtetë kënaqësi të jem sot këtu dhe të kem mundësinë të jem para kësaj audience në emër të Ambasadorit Salzmann.

Me këtë fjalim dëshiroj të tërheq vëmendjen tuaj në çështjet e menaxhimit të kufijve të ndërlidhura si me sigurinë rajonale ashtu dhe me rrugën e Shqipërisë drejt integritit evropian. E para nga këto çështje për Shqipërinë është papajtueshmëria aktuale me standartet e kontrollit të kufijve në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht me detyrat e kufirit bregdetar, të ushtruara nga Rojet Bregdetare, dhe së dyti vonesa e Shqipërisë në zhvillimin e një strategjie mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve.

Shumë nga ju mund të mbajnë mend se në kuadrin e “Konferencës Rajonale të Ohrit mbi Sigurimin e Kufijve dhe Menaxhimin”, parashikuar dhe në Paktin e Stabilitetit, OSBE dhe BE, të pesë vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë dhe Shqipërinë, nënshkruan të ashtuquajturën “Platformë të Përbashkët mbi Sigurimin e Kufijve dhe Menaxhimin” (22-23 maj 2003), duke u angazhuar me parimin e “komandimit civil” për të gjitha agjensitë e përfshira në veprimet e kontrollit të kufijve.

Shqipëria ka përfituar nga aplikimi në praktikë i këtij parimi, në sajë të së cilit të gjithë trupat ushtarake malazeze dhe ato të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë përgjatë kufijve me Shqipërinë janë zëvendësuar nga forcat civile të policisë në këto dy vite të fundit. Por Shqipëria, në kontrast me këtë, akoma nuk ka çmilitarizuar kontrollin e kufirit të saj detarë, cili mbulohet akoma nga Rojet Bregdetare nën komandën ushtarake.

Situata aktuale në Shqipëri është gjithashtu e papajtueshme me standartet evropiane të policimit, që kërkojnë që të gjitha agjensitë e zbatimit të ligjit me pushtet juridik policor të jenë nën komandën civile.¹ Kjo situatë gjithashtu nuk përshtatet me qëllimet e Partnershipit të NATO-s në fushën e sigurisë së kufijve dhe – siç e kam thënë deri tani - cënon detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë

¹ Në Bashkimin Evropian sikurse dhe në demokracitë perëndimore, autoriteti ushtarak mbi civilët mund të ushtrohet vetëm në raste të jashtëzakonshme (si në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme) dhe për një periudhë të caktuar kohe.

në lidhje me parimet e kontrollit të kufijve.

Duke iu referuar ekspertëve të ndryshëm, ekzistojnë tre zgjidhje të mundshme për këtë problem.

E para dhe më e rëndësishmja mund të jetë heqja e menjëhershme e kontrollit të kufijve dhe kompetencave juridike policore Rojes Bregdetare, duke kufizuar rolin e saj në veprime të pastra ushtarake, si mbikqyrja dhe mbledhja e informacionit. Problemi me këtë zgjidhje është se Drejtorja e Kufijve dhe Emigrimit e PSA nuk është plotësisht e gatshme për të ndërmarrë kontrollin e kufijve detarë, për shkak të mungesës për nevoja teknike dhe materiale si edhe burimeve njerëzore dhe financiare. Kështu që kufiri detar do të mbetet i pakontrolluar, dhe kjo nuk përbën një zgjidhje të vlefshme.

Zgjidhja e dytë është vendosja e Rojes Bregdetare si pjesë përbërëse e Drejtorisë Policore të Emigrimit dhe Kufijve pranë Policisë së Shtetit Shqiptar, duke transferuar personelin, mjetet dhe burimet. Kjo do të përmbushte heqjen formale të Rojes Bregdetare dhe njohjen e saj si një strukturë policore civile. Problemi në këtë çështje është se kjo do të përbëjë një proces të gjatë, kompleks dhe të kushtueshëm, cili shumë mirë mund të evitohet.

E treta dhe ndoshta zgjidhja më e mundshme është transferimi vetëm i komandës operuese nga Roja Bregdetare te Ministria e Brendshme², duke ruajtur organizimin ushtarak dhe varësinë për të gjitha çështjet e brendshme, duke përfshirë karrierën, rangjet, statutin, etj. Këto lloj organizimesh mund të gjenden në mjaft vende të BE-së si Spanja (Roja Civile, e cila është gjithashtu përgjegjëse për ruajtjen e bregdetit), Itali (karabinierët), Francë (xhandarmëria) etj.

Gjithashtu duhet të vërehet se vendosja e një oficeri policor civil në çdo bord të Rojes Bregdetare ndërsa patrollojnë kufirin detar, nuk është e pranueshme, sepse edhe nëse ajo zgjidh problemin e autoritetit civil për qëllime policimi, ajo nuk do ta sjellë Rojen Bregdetare në përputhje me parimin e komandimit civil. Kjo do të sjellë, përveç oficerit policor civil në bord edhe Roja Bregdetare do të jetë nën veprimin e komandës civile për të gjitha qëllimet e kontrollit të kufijve (të rekomanduara më sipër). Ky përbën një shembull, një zgjidhje të Koracisë, e cila mund të konsiderohet si model i vlefshëm i Ballkanit Perëndimor për Shqipërinë

Çështja e dytë që do të dëshiroja të ngrija sot është vonesa e Shqipërisë në zhvillimin e një strategjie të Menaxhimit të Integruar të Kufijve.

Përveç emrit, "Strategjia Kombëtare Shqiptare mbi Kontrollin e Kufijve dhe Menaxhimi i Integruar" e miratuar nga parlamenti shqiptar në shkurt të 2003 nuk është ajo çka ne quajmë Strategji e Integruar e Menaxhimit Kufitar, e cila është hartuar nga Ministri i mëparshëm i Rendit Publik dhe është fokusuar kryesisht në policimin e kufirit.

Në mënyrë që të lehtësohet krijimi i strategjive reale të menaxhimit të integruar të kufijve në rajon, në tetor të 2004 Komisioni European u dha pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë dhe Shqipërinë, të ashtuquajturën

² Urdhri i kryeministrit 17/2006, 6 shkurt 2006

“Udhëzues i BE mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve për vendet e Ballkanit Perëndimor”. Disa muaj më vonë një projekt specifik rajonal CARDS u lançua me qëllimin e asistencës ndaj pesë vendeve në zhvillimin e strategjive të menaxhimit të integruar të kufijve (MIK) duke siguruar një kordinim mes tyre. Që atëherë, vendet e përfshira – përveç Shqipërisë – kanë përparuar në zhvillimin e strategjisë së tyre kombëtare mbi MIK. Në disa raste këto strategji janë aprovuar nga parlamentet kombëtare.

Në rastin e Shqipërisë, grupi i punës ndërministror i ngarkuar me përgjegjësinë e hartimit të strategjisë së MIK të Shqipërisë nuk ishte krijuar ende nga qeveria shqiptare deri disa javë më parë, e cila përbënte dhe afatin e fundit për përfundimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit në 28 mars 2006.

Zhvillimi i strategjisë së MIK kërkon përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të gjitha agjensive të përfshira në menaxhimin e kufijve (policia e kufirit, doganat, inspektoriatit sanitar, autoritetet e transportit dhe mjedisit, etj). Krijimi formal i këtij grupi pune ndërministror ad hoc është një arritje e mirëpritur.

Në rast të mosekzistencës joformale të grupit ndërqeveritar të punës, përparim është bërë muaj më parë nga një grup pune informal, duke përfshirë dhe Drejtorinë e Kufirit dhe Emigracionit të Policisë së Shtetit Shqiptar, Shërbimin e Doganor Shqiptar si dhe inspektoriatet veterinarë dhe sanitare të Ministrisë së Bujqësisë, me asistencën e PAMECA, CAM-A and ICITAP.

Zhvillimi i një Strategjie për Menaxhimin e Integruar të Kufijve nuk është vetëm një tjetër kërkesë teknike në kontekstin e procesit të Asocim Stabilizimit me BE-në, por një mjet i rëndësishëm për të luftuar krimin e organizuar ndërkufitar, për të lehtësuar krijimin e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorëve; gjithashtu kontribuon në forcimin e sigurisë rajonale përmes bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje. Do të jetë shumë e vështirë në Shqipëri për të imagjinuar lëvizje të lirë përmes liberalizimit të vizave përpara se një strategji e vërtetë e Menaxhimit të Integruar Kufitar të krijohet dhe të zbatohet pa probleme.

Është pra shumë e rëndësishme që grupi i punës ad hoc ndërqeveritar të përfundojë Strategjinë Shqiptare të Menaxhimit të Integruar të Kufijve dhe Planin Kombëtar të Veprimit pa asnjë vonesë tjetër. Megjithëse ky afat i fundit është parashikuar me urdhër të Kryeministrit, puna duhet të vazhdojë derisa ajo të përfundojë me sukses.

“REFORMIMI I POLICISE SE SHTETIT DHE SIGURIA NDERKUFITARE”

Karl Schmitt
PAMECA

Eshtë kënaqësi që marr pjesë në këtë veprimtari të rëndësishme dhe që kam privilegjin të ndaj me ju opinionin tim mbi sfidat e sigurisë rajonale të Shqipërisë. Duke përfaqësuar një Mision në Ndhimë të Policisë në Shqipëri, i cili mbështet dhe ndihmon Policinë e Shtetit, unë do të fokusohem mbi çështje që lidhen me drejtësinë dhe rendin, në mënyrë të veçantë me policimin.

Arritjet dhe Dështimet e Institucioneve Shqiptare

Duke qëndruar në këtë vend që nga shkurti i vitit 2001 dhe duke qenë dëshmitar i disa proceseve politike, ekonomike dhe sociale të pesë viteve të fundit, unë do t'i konsideroja Zgjedhjet Parlamentare të 2005 dhe ndërrimin e rregullt të pushtetit, si një arritje të rëndësishme demokratike, ku Policia e Shtetit tregoi maturi, paanësi dhe profesionalizëm në garantimin e një procesi të lirë e të qetë nga pikëpamja e policimit, gjë që pati një ndikim pozitiv në stabilitetin e Shqipërisë si edhe në sigurinë rajonale. Retorika e qeverisë për të luftuar pa kompromis krimin e organizuar, krimin transnacional, trafiket ilegale dhe terrorizmin nuk ka munguar asnjëherë, por ajo bëhet e kuptimplotë dhe e besueshme për komunitetin vetëm në qoftë se ndërmerren veprime konkrete. Ndalimi i disa pjesëtarëve të klaneve kriminale pranë personaliteteve të larta dhe gjithashtu të përfshirë në rrjetet kriminale të organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar, është një tjetër arritje e institucioneve shqiptare, që po shndërrohen nga konsumues në kontribues të paqes dhe sigurisë në rajon.

Një tjetër zhvillim domethënës që është akoma në proces, por drejt finalizimit, është riorganizimi total dhe ristrukturimi i Ministrisë së Brendshme dhe i Policisë së Shtetit, që pasqyron realitetin e ri si edhe kërkesat e reja e shtruara para Shqipërisë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Kjo ka sjellë ndryshime të pashmangshme dhe transferime në radhët e Policisë së Shtetit, por me përfundimin e tyre ne besojmë se do të kemi organizimi efikas dhe efektiv të policisë, një shërbim profesional të aftë për të përballuar dhe luftuar krimin, trafiket, krimin e organizuar dhe terrorizmin.

Bashkëpunimi Institucional Ndërkufitar

Tashmë ka një rrjet të gjerë që e mbulon rajonin me nisma bashkëpunuese

në nivele të ndryshme. Njëra prej tyre është SECI, Qendra Rajonale për Luftën Kundër Krimit Trans-Kufitar, me qendër në Bukuresht. Shtetet anëtarë të SECI-t i japin rëndësi të veçantë luftës kundër krimit ndërkufitar dhe korrupsionit. Kjo kërkon në mënyrë të ngutshme prej të gjitha vendeve të rajonit një Menaxhim të Integruar të Kufirit që të jetë i përditësuar, si edhe kërkon strategji vizionare që do të çojnë te një integrim i plotë në strukturat dhe instrumentat e BE. Për këtë arsye, qeveria shqiptare në partneritet të ngushtë me misionet ndërkombëtare të policisë që veprojnë në Shqipëri, janë aktualisht duke punuar për këtë strategji të Menaxhimit të Integruar të Kufirit, gjë që përbën themelin për sukses të mëtejshme. Më shumë përpjekje duhet të investohen në mënyrë që strategjia të kompletohet brenda afateve të parashikuara, për të ecur kështu në një hap me ristrukturimin total të Policisë së Shtetit. Përveç të gjitha këtyre, duhet të theksojmë se bashkëpunimi rajonal është duke u përmirësuar gradualisht. Kjo dëshmohet jo vetëm në nivele të larta, por edhe në ato operacionale. Megjithatë, besojmë se bashkëpunimi midis agjensive të zbatimit të ligjit duhet të zjgërohet më shumë në mënyrë që të arrihet sukses më i madh në luftën kundër krimit trans-kufitar.

Strategjia Rajonale e Sigurisë

Më 2005, pesëmbëdhjetë vjet pas rënies së komunizmit, dhjetë vjet pas Marrëveshjes së Dejtonit dhe pesë vjet pas rënies së regjimit të Millosheviçit, anëtarë të Rrjetit të Rinor të DCAF (të rinj profesionistë, aktivistë të OJQ-ve, zyrtarë qeveritarë, dhe gazetarë të SEE) kanë përpiluar një Strategji Rajonale të Sigurisë për vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo Strategji ka për qëllim të arrijë një konsensus mbi çështjet më kryesore të sigurisë rajonale. Qëllimi kryesor i saj është të përmirësojë kordinimin mbi sigurinë dhe, në fund të arrijë në propozime konkrete mbi masat konstruktive ndërmjet vendeve të rajonit. Qëllimi kryesor afatgjatë i kësaj Strategjie është krijimi i vetëbesimit të nevojshëm për vendet e Ballkanit Perëndimor për të ndërmarrë çështje dhe nxitur ndryshime, të cilat të drejtojnë në një integrim në NATO dhe BE

Një tjetër Strategji rajonale është hartuar nga Projekti CARPO në kuadrin e forcimit të kapaciteteve policore kundër krimeve serioze në Europën Juglindore “Zhvillimi dhe Riaftësimi i Sistemeve Funkcionuese Policore dhe Intensifikimi i Luftës kundër Aktivitetve Kriminale Kryesore dhe Bashkëpunimi Policor”. Kjo Strategji Rajonale mbi Mjetet kundër Krimit të Organizuar dhe Ekonomik është hartuar në takimin rajonal të CARPO-s në Strasburg më 29 Gusht 2005. Shtatë vende të rajonit pjesëmarrëse në projektin CARPO (Shqipëria ishte njëra prej tyre) nënshkruan strategjinë dhe ranë dakord ta ratifikojnë duke përfshirë faktin e rritjes së mjeteve kundër krimit të organizuar në mënyrë që të vihet në një linjë me standartet europiane dhe ndërkombëtare.

Masat që duhen marrë

Natyra e rrezikut për krimin e organizuar ndërkombëtar e bën bashkëpunimin

ndërmjet shteteve mënyrën e vetme të efektshme për ta luftuar atë. Shtetet në rajon duhet të adaptojnë sjelljen e bashkëpunimit që tashmë ekziston ndërmjet grupeve kriminale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Pikat në vijim mund të shëbejnë si zgjidhje në fushën e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme:

- Përmirësimi i shërbimeve të shpërndarjes dhe i mbledhjes së informacionit në luftën kundër krimit të organizuar dhe Terrorizmit;
- Krijimi i një Baze të Dhënash mbi Krimin e Organizuar Rajonal (mbledhje e të dhënave gjatë hetimeve/gjyqeve, profileve të individëve, grupeve dhe krimeve të kryera) me të drejta hyrjeje nga të gjitha agjensitë e zbatimit të ligjit të rajonit;
- Krijimi i një Grupi Hetimor Ndërkombëtar
- Rritja e bashkëpunimit mes strukturave investigative (të ngjashme me modelet e përdorura në vitet '70 dhe '80 për të luftuar mafian në Itali, SHB, etj.)

Në filozofinë e Strategjisë Rajonale mbi Sigurinë mbledhja e burimeve të Ballkanit Perëndimor është jo vetëm më e kushtueshme se përpjekjet individuale të shteteve por gjithashtu lejon ndarjen e eksperiencave më të mira. Rekomandime praktike të tilla si:

- Krijimi i Policisë Ballkanike
- Krijimi i Bashkëpunimit DNA rajonal
- Krijimi i një Qendre Bashkëpunimi të Hartimit Ligjor
- Vizat Smart (qarkullim i lirë i kategorive të caktuara të personave).
- Hyrja e Bazës së të Dhënave të Përbashkët mbi Imigrimin në bazën e të Dhënave Shengen në vend të koncentrimit tek ndryshimeve dhe rreziqet, do të koncentrohen në interesat e përbashkëta dhe zgjidhjet për vendet e rajonit.

Janë të shumta fushat të cilat janë konsideruar vitale për të siguruar dhe përmirësuar sigurinë rajonale. Megjithatë, kjo pengesë është e përbashkët ndërmjet vendeve të rajonit, sepse është e bazuar në bashkëpunimin e gjerë ndërmjet autoriteteve përgjegjëse të të gjitha niveleve. Ky bashkëpunim duhet të fokusohet në fushat e mëposhtme:

- Bashkëpunimi Ndërkufitar i cili përfshin:
- Bashkëpunimin ndërmjet Qeverive qendrore dhe Lokale
- Bashkëpunimin në Drejtësi (prokurori dhe gjyqësor)
- Bashkëpunimin Policor (ndërmjet drejtorive të ndryshme të policisë në rajon)
- Bashkëpunimin në fushën e Doganave
- Bashkëpunimin në Shërbimet Informative dhe të Sigurisë

Aspektet e mëposhtme duhet të merren në konsideratë:

- Legjislative
- Gjyqësore

- Strategjike
- Taktike
- Operuese
- Mbledhja e Informacionit dhe komunikimi

Parandalimi i Krimit dhe Progranet e Represionit

Vëmendje e veçantë duhet t'i jepet parandalimit rajonal dhe qendror si edhe programeve të represionit në fusha specifike të krimit si :

- Krime të organizuar
- Trafikimi i Drogës
- Pastrimi i Parave
- Trafikimi i Qënieve Njerëzore
- Terrorizmi Ndërkombëtar etj.

Konsultimet e vazhdueshme

Eshtë shumë e rëndësishme të caktohen rregulla dhe rregullore për të pasur konsultime të vazhdueshme profesionale midis vendeve të rajonit në të gjitha nivelet.

Së fundmi, do të doja të përmendja se Komisioneri i Giuliano Amato, i re-komandoi BE-së një anëtarësim të shpejtë të Shteteve Ballkanike. Duke mbyllur fjalimin tim, do të doja t'i referohesha raportit të Komisionit Ballkanik: "Ajo çfarë nevojitet është përgatitja deri në fund të 2006 e një udhëzuesi të qartë rajonal që kombinon qasjen rajonale që përfshin të gjithë popujt e Ballkanit Perëndimor si anëtarë të ardhshëm të BE dhe NATO-s, me afata dhe kushte specifike për secilin vend".

“SEDM: NJW NISME E SUKSESSHME RAJONALE PER SIGURINE KOLEKTIVE”

*Prof. Dr. Besnik Baraj
Kryetar i Komitetit të Kordinimit
të Ministrive të Mbrojtjes së Evropës Juglindore*

Kam kënaqësinë të jem këtu sonte si Kryetar i Komitetit të Kordinimit të Ministrive të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM-CC) dhe i Komitetit Drejtues Politiko-Ushtarak (PMSC) të Forcës Shumëkombëshe të Paqes së Evropës Juglindore (MPFSEE). Më lejoni që së pari t’ju përcjell përshëndetjen time të sinqertë të gjithëve ju dhe veçanërisht organizatorëve të kësaj veprimtarie të rëndësishme.

Prezantimi im ka për qëllim t’ju japë një shikim të përgjithshëm të procesit Ministror të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM) dhe të ndihmesës së tij për të çuar përpara kontributet e SEDM dhe MPFSEE në sigurinë dhe stabilitetin rajonal, duke thelluar bashkëpunimin e vendeve të SEDM në përballjen me kërcënimet e mundshme, në radhë të parë luftën kundër terrorizmit.

Vendeve të Evropës Juglindore u është dashur të përballen me shumë vështirësi që janë shoqërojnë gjithmonë periudhat e tranzicionit. Për këto arsye kombet e Evropës Juglindore ishin të ndërgjegjshëm që duhet të përgatiten për t’iu përkushtuar rindërtimit politik, të sigurisë, ekonomik dhe social. Në këtë kuadër Ministrat e Mbrojtjes së nëntë vendeve të Evropës Juglindore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nisën procesin SEDM që synon të japë ndihmesë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe të thellojë bashkëpunimin rajonal. Gjatë takimit vjetor ministror të SEDM që do të mbahet në Uashington më 6 dhjetor 2006 Ukraina do të bëhet anëtare e procesit. Moldavia ka statusin e vëzhguesit në takimet e SEDM dhe Serbia dhe Mali i Zi kanë kërkuar të anëtarësohen.

Procesi i SEDM mbledh së bashku, nën të njëjtën çadër, vende të NATO-s dhe vendet të Parteneritetit për Paqe.

SEDM ofron një kuadër të vlefshëm politik dhe ushtarak, thellon bashkëpunimin rajonal, formëson mendësitë dhe nxit bashkëpunimin midis vendeve që kanë qëllime të përbashkëta mbi sigurinë.

SEDM i jep një përmasë të re diplomacisë së mbrojtjes me anë të përbërësit ushtarak, që është Brigada Evropiane Juglindore (SEEBRIG), përvoja e parë e suksesshme, siç na pëlqen ta quajmë, një forcë rajonale vërtet shumëkombëshe në Evropën Juglindore.

SEEBRIG, formacioni i vetëm paqeruajtës shumëkombësh i themeluar ekskluzivisht prej kombeve të Evropës Juglindore, deklaroi gatishmëri operacionale

më 1 maj 2001. SEEBRIG është një prej mundësive që vendet e Evropës Juglindore mund të ofrojnë kur t'u kërkohet të mbajnë një pjesë të peshës që nxitjes së sigurisë dhe stabilitetit në Evropës Juglindore. Përpjekje po bëhen që të arrihet ndëroperacionaliteti me forcat e NATO-s dhe të përmirësohet niveli i trainimit duke përfshirë personelin e SEEBRIG në stërvitjet e përbashkëta NATO – Partneritet për Paqe. Pas shumë vjetësh stërvitjeje, për të parën herë SEEBRIG po merr pjesë në një Mision për Mbështetjen e Paqes në Kabul, Afghanistan, për gjatë muaj duke filluar nga 6 shkurt 2006.

Një numër projektsh po zbatohen brenda kontekstit të SEDM-CC:

SIMIHO – Ndërlidhja Satelitore e Spitaleve Ushtarakë, me qëllimin e ndërlidhjes së spitaleve ushtarakë të vendeve pjesëmarrëse. Më konkretisht, qëllimi i programit është ndërlidhja e një spitali ushtarak të secilit prej vendeve të SEDM për ushtrimin e telemjekimit dhe të shkëmbimit të informacionit mjekësor me anë të lidhjes satelitore. Përveç kësaj ndërlidhjeje, spitalet do të kenë mundësinë për t'u lidhur me qendra më të specializuara mjekësore dhe/ose me spitale përtej kufijve të vendeve SEDM, në rast se ato përdorin aparatura ndërlidhjeje të ngjashme.

Rrjeti Evropian i Simulimit. Në tetor 2000, dhjetë ministrat e mbrojtjes së SEDM miratuan propozimin e Shteteve të Bashkuara për një Rrjet Simulimi Juglindor (SEESIM). Me anë të një serie të stërvitjeve bazuar në simulim, SEESIM është projektuar që të shërbejë si një themel për integrimin e disa nismave që funksionojnë në kuadër të SEDM. Këto nisma përfshijnë Brigadën e Evropës Juglindore (SEEBRIG) dhe Task Forcën Inxhinierike (ETF); seminare për planifikimin civilo-ushtarak të urgjencave (CMEP); dhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit për Partneritetin për Paqe (PIMS), të mbështetur nga Shtetet e Bashkuara. SEESIM shërben si një prelude i stërvitjeve rajonale të vërteta dhe operacioneve të vërteta të urgjencave.

CBSC – Kundër Përhapjes së Armëve, Siguria e Kufirit, dhe Kundërterrorizmi. Një dekadë ndryshimesh në Evropën Juglindore, ngjarjet terroriste të 11 Shtatorit në SHBA dhe procesi i përshtatjes së NATO-s në mjedisin e ri të sigurisë, përforcon vetëdijen brenda komunitetit ndërkombëtar për nevojën e parandalimit dhe të kundërshtimit të përhapjes së Armëve të Shkatërrimit në Masë, fuqizimin e sigurisë kufitare dhe ndërmarrjen e hapave konkretë për të luftuar terrorizmin ndërkombëtar në të gjitha format e tij.

SEEDIRET – Bashkëpunimi mbi Industrinë e Mbrojtjes, Kërkim dhe Teknologji. Zv/ministrat e mbrojtjes të vendeve të SEDM bënë marrëveshje gjatë takimit të pestë në Bukuresht (18 tetor 2002) për të nxitur bashkëpunimin e vendeve të SEDM në çështje të Industrisë së Mbrojtjes dhe Kërkimeve e Teknologjisë dhe t'ia ngarkojnë këtë veprimtari një grupi pune të përbërë nga ekspertë të nivelit të lartë. Ky është një projekt në vazhdim që synon të përfshijë shkatërrimin e armëve të vogla dhe municioneve.

Më 1 korrik 2005, Shqipëria mori prej Turqisë kryesimin e Komitetit të Kordinimit të Ministrive të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM-CC) dhe i

Komitetit Drejtues Politiko-Ushtarak (PMSC) të Forcës Shumëkombëshe të Paqes së Evropës Juglindore (MPFSEE). Objektivat më domethënëse të kryesimit të Shqipërisë janë të ruajë karakterin e hapur të procesit të SEDM, të risë marrëdhëniet e SEDM me nisma të tjera të Evropës Juglindore – Nismën e NATO-s për Evropën Juglindore (SEEI), SEEGROUP, Paktin e Stabilitetit, Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (SEECp) dhe të përshtasë kuadrin e bashkëpunimit të SEDM në mënyrë që të adresojë sfidat jokonvecionale dhe joushtarake ndaj sigurisë rajonale, siç është terrorizmi.

Shqipëria, si vend që ka kryesimin, është e vendosur të punojë së bashku me NATO-n dhe vendet partnere për ta kthyer SEDM në njërin prej kontributeve kryesore për sigurinë dhe stabilitetin në Evropën Juglindore, duke qenë vetëqëndrueshmëria e sigurisë dhe e stabilitetit në rajon është qëllimi final i përfshirjes së bashkësisë ndërkombëtare në rajon.

Shënime përbyllëse:

Ka shumë gjëra që duhen bërë për të zbatuar në mënyrë të plotë këto nisma. Por duhet ta pranojmë që këto projekte janë duke u ofruar vendeve pjesëmarrëse të Evropës Juglindore mjetet e nevojshme për t'i provuar bashkësisë ndërkombëtare se ato po evoluojnë nga statisi i konsumuesit të sigurisë në atë të ofruesit të sigurisë. .

Është e qartë se ne duhet të marrim më shumë përgjegjësi menaxhimin e krizave në rajonin tonë. Në këtë kontekst, SEDM është njëra nga nismat e pakta rajonale që ka evoluar me sukses në këtë fushë, duke pranuar anëtarë të rinj dhe duke zmadhuar shtrirjen e saj gjeografike.

SEDM jo vetëm që ka siguruar kuadrin për këshillime dhe bashkëpunim midis anëtarëve, por gjithashtu ka arritur që me sukses të nxisë një kulturë të transparencës dhe mirëbesimit. SEDM është një model i bashkëpunimit për të tjera fusha si një strukturë vërtet shumëkombëshe e sigurisë rajonale në Evropën Juglindore.

Më lejoni për përfundoj duke riafirmuar se SEDM është një proces konsistent dhe një provë e së vendet e Ballkanit kanë ndryshuar më ngadalë, por me vendosmëri, statusin e tyre nga “konsumues të sigurisë” në “ofrues të sigurisë”.

“NDIHMESA E OSBE NE ÇESHTJET E SIGURISE”

Jack Bell,

Departmenti i Sigurisë dhe i Bashkëpunimit, OSBE

Ndjehem mirë që jam këtu dhe ju falenderoj për ftesën! Kjo është një periudhë emocionuese për Shqipërinë, kohë tranzicioni dhe kohë që kërkon punë të madhe nga secili dhe OSBE ndodhet këtu për të asistuar në ndonjë mënyrë që mundemi, sikurse kemi bërë në vende të tjera të Evropës Juglindore.

OSBE ekziston që prej 30 vitesh dhe është organizata më e madhe rajonale e sigurisë në botë. Ne kemi 55 shtete anëtarë që gjeografikisht shtrihen prej Vankuverit në Vladivostok dhe të gjithë anëtarët tanë janë të interesuar për sigurinë e Evropës dhe të Shqipërisë. Ne dëshirojmë që të mos ta shohim kurrë më kaosin e viteve 1990 do të bëjmë gjithçka në fuqitë tona për të ndihmuar për të parandaluar përsëritjen e konflikteve.

Tani OSBE punëson rreth 460 persona në institucione të ndryshme dhe rreth 3,000 punonjës në operacionet në terren, që janë 16, duke u shtrirë nga Kroacia në Bishkek.

Prania e OSBE në Shqipëri përbëhet prej tri departamentesh: Departmenti i Dimensioneve Njerëzore, që zakonisht në Shqipëri punon mbi zgjedhjet dhe shtetin ligjor, Departamenti i Mirëqeverisjes, i cili është i përfshirë në çështjet e pronësisë dhe departamenti që kryesoj, ai për Siguri dhe Bashkëpunim, i cili merret me programe asistence për policinë, normalisht programe për të ndihmuar policinë e kufirit dhe të emigracionit.

Më parë, aktivitetet e OSBE të lidhura me kufijtë fokusoheshin mbi monitorimin e kufijve, për të ndërtuar mirëbesim midis shteteve. Por, kohët kanë ndryshuar. Kufijtë janë më të sigurtë dhe tashmë ka më shumë mirëbesim midis shteteve.

Tani aktivitetet tona janë të drejtuara më shumë për nga mbështetja e reformës së policisë kufitare, policimi i kufirit si edhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkufitar. Objektivi kryesor është të parandalojë dhe luftojë krimin e organizuar, emigracionin e paligjshëm, trafikimin e armëve, drogave dhe qënieve njerëzore. Kjo është puna e OSBE në Shqipëri.

Ne kemi disa programe që po zbatohen në Shqipëri për të ndihmuar policinë kufitare për sigurimin e kufirit. Këta programe janë:

Një program për mësimin e një gjuhe të dytë (anglisht) që në kohën kur flasim po trainon rreth 200 oficerë policie në pesë vendndodhje të ndryshme;

Ndihmesë për reformën e Ligjit të Policisë së Shtetit;

Lehtësimi i bashkëpunimit ndërkuftar, tani për tani midis Kosovës dhe Shqipërisë, por që shpejt shpresojmë ta shtrijmë midis Maqedonisë dhe Shqipërisë, si edhe Midis Serbisë dhe Malit të Zi dhe Shqipërisë;

Një panel solar i cili siguron një burim alternativ elektriciteti në pika kryesore të klaimit të kufirit; dhe

Trainimi i mbi 100 oficerave të policisë në përdorimin e pajisjeve të sofistikuar për mbikqyrjen e kufirit.

Në programin e kësaj konference një nga pyetjet që shtroheshin për diskutim ishte “Ku duhet të përqendrohet Shqipëria tani për të përmirësuar sigurinë në kufij?”. Ajo që unë mendoj se duhet bërë dhe po e përrëris faktin që ne jemi këtu për të dhënë ndihmesën tonë, është si më poshtë::

- Të vazhdohet përpara me reformat dhe punën për Ligjin e Policisë së Shtetit. Rruga e vetme është përpara, nuk ka kthim mbrapa;
- Të vazhdohet me depolitizimin e forcave të policisë. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme;
- Të vazhdohet me bashkëpunimin me vendet fqinjë, veçanërisht me shkëmbimin e informacionit për luftën kundër krimin të organizuar; dhe
- Të vazhdohet puna për bashkëpunimin më të midis departamenteve brenda forcave të policisë së shtetit; nevojitet të kenë më shumë mirëbesim te njëri-tjetri dhe më shumë shkëmbim informacioni, në mënyrë që të ndërtohet një forcë policore më efikase.

E përsëris që tani është një periudhë emocionuese për Shqipërisë dhe unë e shoh atë, pas një kohe të caktuar, si pjesë të Bashkimit Evropian. Do të ketë akoma më shumë punë për të bërë dhe ne jemi këtu për të ndihmuar dhe këtë e bëjmë me kënaqësi.

“MARREDHENIET RAJONALE DHE DIPLOMACIA SHQIPTARE”

Agim Fagu,
Drejtor i NATO-s në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Tashmë është e pranuar nga të gjithë, nga faktori i jashtëm dhe i brendshëm rajonal, përfshi këtu organizatat më në zë në çështjet e promovimit të sigurisë dhe demokracisë si NATO, OKB, BE, OSBE, dhe KE, se organizatat rajonale japin kontribut të rëndësishëm për stabilitetin dhe sigurinë e hapësirës euroatlantike, ndërkohë që ka një sinergji të fuqishme midis procesit rajonal dhe integritit. Është kjo arsyeja që do doja ta vendosja bashkëpunimin rajonal në kuadër të ndërtimit europian të rajonit, në radhën e parë të parimeve për adresimin e sfidave. Në këtë parim themelor të adresimit të sfidave të sigurisë ka edhe dy zhvillime të rëndësishme që lidhen e para me atë të bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimin europian të rajonit që është edhe një nga parimet themelore të politikës së jashtme të Shqipërisë dhe së dyti që ky parim ngjit dhe zhvillohet në një rajon me një histori shume të shkurter bashkëpunimi dhe me një trashëgimi tepër të varfër e krejtësisht të pasuksesshme.

Nuk është i panjohur fakti që Ballkani nuk doli nga rrënojat e perandorive të “Hapsburgëve” dhe “Otomanëve” si “Rajon”, megjithatë kishte qenë ëndrra e parë e lëvizjeve çlirimtare kombëtare dhe luftëtarëve të lirisë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Në të kundërtën, Traktati i Berlinit i 1878, një kuadër ligjor ndërkombëtar për fragmentimin e përhershëm ose “ballkanizimin” e Rajonit, garantoj vetëm këtë sjellje antirajonale.

Pas Luftës së I-rë Botërore, megjithë përpjekjen amerikane të udhëhequr nga Presidenti Īilson, politika ballkanike, e mishëruar si ndonjë konflikt dhe armiqësi, të shfrytëzuara nga fuqitë europiane, rezultoi në sjellje oportuniste dhe nacionaliste, lidhur pas karrocës së aleancave me fuqitë jashtë rajonit. Është po aq e rëndësishme, për të sotmen, të nënvizohet se kjo solli ngadalsimin e zhvillimit ekonomik dhe social të zonës. Ndërsa periudha e Luftes së Ftohtë, i pozicionoi vendet e rajonit në konfliktin e boshtit Lindje-Perëndim, ku vetëm Jugosllavia ishte përfituesja kryesore e kësaj ndarjeje të rajonit, duke shfrytëzuar statusin e të mosangazhuarit, si nga lindja ashtu edhe nga perëndimi.

Megjithatë në vitet 90, konfliktet dhe luftrat dramatike, me epiqendër Jugosllavinë, dhanë shembullin më të keq të mundshëm të trashigimisë dhe mentalitetit të një rajoni, që i kishte ardhur koha jo vetëm të përgenjështonte epitetet aspak tërheqëse ndër shekuj, por të vendoste dhe të tregonte me veprime se i

kishte kthyer kurrizin të kaluarës dhe me qartësi e përkushtim kish bërë hapa të mëdha përpara në drejtim të paqes, sigurisë dhe prosperitetit.

Duket se shekulli i kaluar i dha pothuajse fund mendësisë së vjetër rajonale të zgjidhjes konfliktuale të çështjeve, duke i dhënë më shumë kohë dhe energji ndërtimit të urave lidhëse e përpjekjeve të përbashkëta, duke kuptuar se legjitimizimi i marrëdhënieve rajonale stimulon krijimtarinë dhe iniciativën lokale dhe unifikon politikat ndërkombëtare me aspiratat praktike të popujve të rajonit. Ky bashkëpunim po prodhon dukshëm standarde më të larta jetese, ekonomi moderne, teknologji dhe infrastrukturë, paqe, siguri e prosperitet, një shpresë që vetëm një dekadë më parë dukej si diçka e pamundur për t'u arritur.

Vlerat e bashkëpunimit janë po aq të mishëruara në parimin imponues dhe bashkohor që sfidat e sigurisë të një vendi nuk mund të përballohen nga një vend i vetëm, qoftë ky një vend i madh e i fuqishëm ushtarakisht dhe ekonomikisht, sepse ato nuk janë thjeshtë ushtarake dhe me shkelje kufijsh shtetërorë, por janë komplekse, globale dhe tradicionalisht me natyrë nga më konsirativet dhe jo lehtësisht të parashikueshme dhe të mundshme për t'i parandaluar e përballuar.

Pas 11 shtatorit, është bërë edhe më e qartë se rreziku global për sigurinë përballohet e luftohet me masa globale nga organizatat apo aleanca të afta globale, aleanca që kanë nevojë për kontributin e çdo vendi, pavarësisht nga madhësia.

Parimi i Partneritetit është shumë i rëndësishëm në përballimin e sfidave të sigurisë, në një mjedis sigurie që ndryshon vazhdimisht e që po përfshin gjithnjë e më shumë sfidat e terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, trafikeve të të gjitha llojeve dhe armëve të shkatërrimit në masë. Ndërkohë ky parim bën të mundur krijimin një sistemi kolektiv të sigurisë, pra të një agjensie globale të sigurisë ku NATO mendoj se do të vazhdojë të kontribuojë në mënyrë përcaktuese në ndërtimin e këtij sistemi plotësisht efektiv të sigurisë dhe stabilitetit, duke ruajtur dhe forcuar lidhjen jetike transatlantike, si një nga shtyllat më të pazëvendësueshme për mjedisin e sigurisë euroatlantike. Në këtë kontekst, përherë e më tepër po bëhet e kuptueshme nga të gjithë se sigurimi i kufijve të një vendi realizohet edhe përtej kufijve të fqinjësisë së tij.

Është po ashtu e vërtetë se në dekadën e fundit ka një transformim të vazhdueshëm të Europës Juglindore nga një qeverisje autoritare dhe ekonomi e centralizuar në demokraci perëndimore me ekonomi tregu, që përveç se garanton të ardhmen e zhvillimit të këtyre vendeve, krijon sot mundësinë e një bashkëpunimi për ndërtimin e mekanizmave të bashkëpunimit rajonal si iniciativë e Europës Juglindore, SEDM, ose Procesi i Bashkëpunimit të Europës Juglindore, Pakti i Stabilitetit ose SEEGROUP e deri në Forcën Shumëkombëshe të Paqes për Europën Juglindore, që edhe me kontributin e kryesisë shqiptare të SEDM, u bë e mundur të dërgohet në mision komandimi në Afganistan.

Në këtë kuadër, një vend të veçantë meriton Karta e Partneritetit, ose iniciativa e A-3, që bashkon në një iniciativë bashkëpunimi të tre vendet kandidatë për

anëtarësim në NATO, Shqipërinë, Maqedoninë dhe Kroacinë, të mbështetura nga SHBA-të. Një ndër fushat me efektive të këtij bashkëpunimi është sektori i sigurisë, pa nënvleftësuar bashkëpunimin në fushat ushtarake, politike, shoqërore dhe duke e bërë iniciativën jo vetëm një instrument të forcimit të besimit në rajon, por edhe një shembull për t'u ndjekur përtej rajonit tonë.

Në këtë mjedis të transformuar gjeopolitik, gjeostrategjik dhe gjeoekonomik, është i domosdoshëm reformimi i sektorit të sigurisë dhe në këtë kuadër formulimi i strategjive kombëtare të sigurisë në përshtatje të plotë me këto ndryshime. Bazuar në dokumentat e ngjashëm të partnereve tanë si edhe në vlerësimet dhe rekomandimet e SEECAP, Shqipëria ka tashmë një dokument të ri të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, dokument ku janë përfshirë në mënyrë transparente tërësia e mjeteve dhe instrumentave që garantojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe shtetit nga kërcënimet dhe rreziqet e jashtme dhe të brendshme, të shprehura nëpërmjet sfidave politike, të mbrojtjes, ekonomike, shoqërore, të mjedisit, fatkeqësitë natyrore, terrorizmit, krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme. Duhet thënë se ky dokument i rëndësishëm është konsultuar paraprakisht me grupe të ndryshme nga shoqëria civile.

Në politikën e jashtme, Shqipëria ka për qëllim të sigurojë interesat themelore të sigurisë nëpërmjet:

- Pjesëmarrjes në institucionet ndërkombëtare dhe europiane
- Bashkëpunimit të ngushtë me fqinjët dhe vendet e rajonit
- Pjesëmarrjen aktive në EAPC dhe PfP e vecanerisht në PARP
- Anëtarësimin në NATO.

Eshtë kënaqësi të konstatohet se edhe vende të tjera të rajonit tonë kanë rishikuar strategjitë e tyre të Sigurisë Kombëtare duke i përshtatur ato me zhvillimet e fundit gjeopolitike në Rajon dhe më gjerë, duke u udhëhequr nga parimet dhe standartet demokratike, forcimit të sigurisë, paqes dhe stabilitetit, në mbrojtje të vetvetes, garantues dhe kontribues në kuadrin ndërkombëtar.

Së fundi, mund të them se, eksperiencia pozitive e rajonit tonë po ndihmon në formulimin e marrëdhënieve, interesave dhe strategjive që do t'i japin formë strukturave të ardhshme të sigurisë ndërkombëtare. Strategjia e SHBA-ve dhe BE-së në rajonin tonë, mund të influencojë strategjitë e tyre në lindje dhe jug të rajonit. Megjithatë ka akoma sfida të rëndësishme në rrugën e integritit evropian dhe euroatlantik për rajonin, vizioni i saj tashmë është i qartë, ai i nje Europe të integruar dhe demokratike, pa linja ndarese, ku edhe vendet e rajonit do të jenë kontribuese të sigurisë në zonën euroatlantike e më gjerë.

REKOMANDIMET E KONFERENCES

Prej diskutimeve gjatë seancave të konferencës “Akhendë shqiptare për sigurinë rajonale”, dolën rekomandimet e mëposhtme, drejtuar aktorëve shtetërorë dhe publikë në Shqipëri, që u mbështetën nga pjesëmarrësit.

1. Anëtarësimi në NATO do të thotë më shumë sesa siguri, do të thotë të ndash vlera të njëjta, si liria e individit, ekonomia e tregut, demokracia, paqja. Prandaj, aspiratat integruese euro-atlantike të vendeve të Evropës Juglindore përbëjnë një bazë shumë të mirë për të ndërtuar harmoninë në rajon, zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve dhe marrëdhënie të sigurisë dypalëshe dhe shumëpalëshe.

2. Sfidat ndaj sigurisë në shekullin e ri janë të natyrës globale dhe jo vetëm ushtarake, prandaj përballimi i tyre kërkon kontributet kolektive të komunitetit euro-atlantik, si edhe bashkërendime të aktorëve ushtarakë dhe civilë. Shqipëria si pjesë e këtij komuniteti duhet t’i përshtatet reformave në planin kombëtar dhe të përgatisë një axhendë të sajën për kontributet që duhet të japë për sigurinë ndërkufitare në rajon.

3. NATO është një organizatë në evolim dhe vendet që aspirojnë të bëhen pjesë e saj, nuk mjafton të kryejnë reformat e brendshme institucionale, por duhet të marrin përsipër një rol aktiv për sigurimin në rajonet përkatëse. Në këtë kuadër, Shqipëria duhet të përcaktojë prioritetet e saj në planin rajonal dhe të bashkërendojë nismat me vendet partnere të rajonit, NATO-s dhe BE-së.

4. Karta e Adriatikut është një kuadër i vlefshëm për t’u përdorur nga Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia si përgatitje për hyrjen në NATO dhe si një element i sigurisë dhe bashkëpunimit dhe mirëbesimit rajonal në Ballkanin Perëndimor.

5. Në funksion të integritetit në NATO, përveç reformimit të Forcave të Armatosura, në planin politik Shqipëria duhet të vazhdojë në rrugën e reformave lidhur forcimin e shtetit ligjor, arritjen e standarteve demokratike dhe të drejtave të njeriut, luftën kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve.

6. Policia e Shtetit të vazhdojë përpara me reformat dhe punën për Ligjin e Policisë së Shtetit. Për ndërtimin e një policie efikase nevojitet depolitizimi i personelit, bashkëpunim më i mirë midis departmenteve brenda forcave të policisë

së shtetit, më shumë mirëbesim te njëri-tjetri dhe më shumë shkëmbim informacioni. Policia e Shtetit të vazhdojë bashkëpunimin me vendet fqinjë kundër krimit të organizuar. Një kuadër më i detajuar ligjor nevojitet për të rregulluar marrëdhëniet e Policisë së Shtetit me pushtetin vendor.

7. Në planin e kontrollit kufitar, reformat që janë ndërmarrë për policinë kufitare janë të rëndësishme dhe në rrugë e duhur. Mirëpo, mendimi i komunitetit ndërkombëtar është se Shqipëria duhet të bëjë akoma më shumë që të plotësohet kushti i komandimit civil i forcat kufitare detare dhe të ndërmarrë masat e duhura për plotësimin e standarteve të Menaxhimit të Integruar të Kufijve, që përfshin shumë aktorë, përveç Policisë së Shtetit. Vëmendje i duhet kushtuar nevojave specifike dhe kualifikimit të personelit të policisë kufitare.

8. Për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar, Shqipëria duhet të vazhdojë të kontribuojë në bashkëpunime ndërkufitare si p.sh. bashkëpunime në nivel qendror dhe vendor, në drejtësi (prokurori dhe gjyqsor), bashkëpunimin policor, në doganave, apo në shërbimet informative. Gjithashtu Shqipëria duhet të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të jetë promovuese e nismave të tilla si krijimi i një baze të dhënash mbi krimin e organizuar, krijimi i një policie ballkanike, i grupeve të përbashkëta të hetimit.

9. Institucioni bashkërendues i Ministrive të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM) dhe Brigada Evropiane Juglindore (SEEBRIG), janë një arritje e bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë dhe në frymën e integritit euro-atlantik, që duhet vazhduar dhe çuar më tej.

10. Objektiv i i rëndësishëm i shtetit shqiptar duhet të jetë lehtësimi i lëvizjes ndërkufitare të njerëzve dhe mallrave. Të studiohet situata në zonat kufitare dhe t'i përgjigjet kërkesave të tyre me anë të marrëveshjeve ndërshtetërore të hapjes së pikave të reja të kalimit të kufirit, me anë të rregullimit të infrastrukturës doganore, etj.

11. Për intensifikimin e lëvizjeve dhe marrëdhënieve shumëplanëshe ndërkufitare duhen bërë investime në infrastrukturën ekzistuese dhe në rrugë të reja. Ndërtimi i rrugëve si Korridori 8, Durrës-Morinë apo i Rrugës së Arbit kishte për t'i integruar zonat kufitare me rrjedhat kombëtare, rajonale dhe globale.

12. Për të dhënë një kontribut në sigurinë rajonale, nevojitet një bashkërendim i pushtetit qendror dhe atë vendor. Pushteti vendor duhet të jetë pjesë e rëndësishme e strategjive të reformave për integrimin në NATO.

13. Pushteti vendor në Shqipëri duhet të jetë më aktiv dhe të marrë më shumë përgjegjësi në lidhje me shtrirjen e marrëdhënieve ndërkufitare. Ekziston mundësia e lidhjeve të partneritetit me pushtetin vendor matanë kufirit, por për krijimin e Euro-Rajoneve që do të japin më shumë zhvillim dhe siguri për zonat kufitare.

14. Marrëdhëniet ndërkufitare janë të rëndësishme për banorët e zonave kufitare të Shqipërisë dhe kjo duhet të mbahet parasysh në përgatitjen e strategjive të sigurisë nga ana e shtetit. Më parë për shkak të pozitës së tyre ato kanë qenë ndër zonat më të izoluar dhe të varfëra të vendit. Rrjedhimisht marrëdhëniet

ndërkufitare shihen prej tyre si një strategji zhvillimi. Tashmë disa zona kufitare të Shqipërisë janë më të orientuara drejt qendrave ekonomike dhe sociale të vendeve fqinjë se sa nga tregu kombëtar apo Tirana.

15. Shoqëria civile ka rol të rëndësishëm për të luajtur për sensibilizimin e shoqërisë mbi sigurinë rajonale, si në nivelin qendror, si në atë vendor. Në bashkëpunim me aktorë të tjerë, bashkëpunimet ndërkufitare të shoqërisë civile rrisin mirëbesimin dhe kanë efekt parandalues ndaj destabilitetit rajonal.

“NATO: Challenges and prospects”

Sotiraq Hroni

Executive director of the Institute for Democracy and Mediation

An Albanian agenda on regional security is overall a guide vision for a democratic Europe without separator lines, where NATO enlargement is a determined step towards this vision. This conference attempts to treat Albanian challenge for NATO integration by making evaluations, defining recommendations for these issues such as the collaboration scale and coordination from the central and local powers with partner structures of the neighbor countries for stimulating and development of boundaries zones, nature misfortune prevention and environment degradation etc.

Albanian security challenges are in the same time regional security challenges, not a single state can face these challenges, therefore regional and international collaboration and the continues process of integration are indispensable for the approximation of a secure and prosperous future for the regional citizens rely upon European values. For this reason is expected a special emphases on Albanian initiative for the legal regulation and deepening of the cross border collaboration and exchange. Another important issue I think is the increase and the consolidation of the managerial capacities in the local administrations to take part in necessary project and encourage cross border collaboration.

“Albanians will be forever grateful to NATO”

Sali Berisha
Prime-minister of Albania

Why is NATO so important to Albania and why the Albanians support so strongly the North Atlantic Alliance? Firstly, I think that the membership of Albania in NATO is the best way to guarantee peace, stability and security in their country. Secondly, given the fact that NATO is a political organization of free countries, entry to NATO is of outmost importance for the consolidation of democracy, individual freedom, rule of law, and economic development. Thirdly, the participation of Albania in this very respected club, in the most successful political and military Alliance in all times, sometimes makes our small country to gain prestige and the right to transmit powerfully through this forum its voice and its vision for a more secure world. Lastly, Albanians as a nation are forever grateful to NATO. It was this Alliance that undertook the protection of the human freedoms and rights, in the biggest military operation in Europe since World War II, and freed Albanians of Kosovo from a repressive regime, an apartheid regime.

During the 57 years of its existence, NATO has guarded with great responsibility its identity as a club of free and democratic countries. This is the reason why Albania, as soon as it came out of the most totalitarian regime of Europe, applied for membership to NATO, becoming the first post-communist country to undertake this step. Having the unshaken belief in the principle that security is won by responsibility, we saw the option of NATO membership as the Pole Star that will guide Albania in her effort for democratization, consolidation of the rule of law and creation of a society where the human rights are fully respected. The strategy of integration of Albania to NATO is based in the action plan for membership. This plan foresees many reforms, whose aim is the development and strengthening of the country by promoting an efficient market economy, strengthening of the institutions, enhancement of democracy, rule of law, repression of criminality and the fight against corruption, the strengthening of the border control, security of ports and blue boundary, reforming of the armed forces, by turning them into a modern, professional army of contemporary standards and capable of responding to the challenges of the new century. We are aware that a lot of work is to be done, especially in the fight against corruption and organized crime, against the phenomenon of state capture. The

NATO membership plan has been and continues to be, the road map, and together with Stabilization Association Process, they are the main projects of the Albanian state and society. Today Albania enjoys more stability, democracy and a clearer vision about its future.

The changes in the global situation necessarily would bring changes in the philosophy and strategy of NATO and would make the Alliance to undertake reforms to face the new situation, and to take over its new role. In this context, I can say that NATO is a reforming alliance, it is an expanding alliance, and Albania is determined to fulfill its criteria, so that in the coming summit that will decide upon expanding the alliance, Albania will get an invitation to join. We guarantee the NATO member countries that we are very determined to undertake whatever step, to pay whatever price, to merit the full membership to NATO, being convinced that this is the most secure future, the future of the greatest security for Albania and Albanians.

“We support Euro-Atlantic aspirations
of Albania and her neighbors”

*HE Marcie Ries
Ambassador of USA in Albania*

